


MJETET E PRAKTIKUESIT NË KUADËR TË UDHËRRËFYESIT



DIREKTIVA E BE-SË MBI PREZUMIMIN E PAFAJËSISË:

MANUAL MBI ZBATIMIN



Rreth “Fair Trials”

“Fair Trials” është një organizatë ndërkombëtare për të drejtat e njeriut me zyre në Londër, Bruksel dhe Uashington, D.C., e cila është e fokusuar në përmirësimin e të drejtës për gjykim të drejtë në përputhje me standardet ndërkombëtare. Puna jonë bazohet në besimin se gjykimet e drejta janë një nga gurthemelet për një shoqëri të mirëfilltë: kjo parandalon rrënimin e jetës nga gabimet e drejtësisë dhe e bënë shoqërinë më të sigurt duke kontribuar në sistemin transparent dhe të besueshëm të drejtësisë për të ruajtur besimin e publikut. Megjithëse në parim njihet si një e drejtë universale, në praktikë e drejta themelore e njeriut për gjykim të drejtë abuzohet në mënyrë rutinore. Puna e “Fair Trials” bënë një kombinim mes: (a) ndihmës dhënë të dyshuarve që të kuptojnë dhe ushtrojnë të drejtat e tyre; (b) ndërtimin e një rrjeti të mbrojtësve të gjykimit të drejtë të angazhuar dhe të informuar (përfshirë OJQ-të, avokatët dhe akademikët); dhe (c) luftimin e shkaqeve themelore të gjykimeve të padrejta nëpërmjet hulumtimit, procesit gjyqësor, avokimit politik dhe fushatave.

Rreth Panelit Këshillëdhënës të Ekspertëve Ligjor

Paneli Këshillëdhënës i Ekspertëve Ligjor (apo LEAP) është një rrjet mbarë evropian i ekspertëve në drejtësinë penale dhe të drejtat e njeriut që punon në promovimin e bashkëpunimit gjyqësor të drejtë dhe efikas brenda Evropës. Aktualisht ekzistojnë 155 anëtarë organizativ, me përfaqësues nga firmat ligjore, OSHC-të dhe institucionet akademike, duke mbuluar të gjitha 28 shtetet anëtare të BE-së.

Përmes koordinimit nga “Fair Trials,” LEAP është në gjendje të ofrojë një pikëpamje eksperte mbi një gamë të gjerë të temave të drejtësisë penale në BE, duke rritur edhe bashkëpunimin ndërmjet mbrojtësve të të drejtave të njeriut në punën ndërkufitare. Rëndësia e LEAP është pranuar nga BE-ja, e cila ka njohur kontributin e rrjetit në drejtësinë e BE-së.

Për më shumë informata, ju lutemi kontaktoni:

Ralph Bunche
Drejtor Rajonal për Evropë
+32 (0)24242354

ralph.bunche@fairtrials.net

Silvia Lorenzo Perez
Asistent për Çështje Ligjore dhe
Politika
+32 (0)2425 8447

silvia.lorenzoperez@fairtrials.net

Gianluca Cesaro
Zyrtar për Komunikim
+32 (0)24258447

gianluca.cesaro@fairtrials.net

Ky publikim është mbështetur financiarisht nga “Programi për Drejtësi (Justice Programme)” i Bashkimit Evropian. Përmbajtjet e këtij publikimi janë nën përgjegjësinë e vetme të “Fair Trials International” dhe në asnjë mënyrë nuk mund të nënkuptohen se pasqyrojnë pikëpamjet e Komisionit Evropian

**Bashkë-financuar nga
“Programi për Drejtësi” i Komisionit Evropian**



Tabela e përmbajtjes

MANUALI MBI PREZUMIMIN E PAFAJËSISË	4
I. HYRJE	4
A. Historiku.....	4
II. OBJEKTIVAT E KËTIJ MANUALI	6
III. FUSHËVEPRIMI I MANUALIT	8
IV. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E DIREKTIVËS.....	9
V. DISPOZITAT E DIREKTIVËS	11
A. Jurisprudenca e GJDBE-së.....	32
i. <i>Parimet e përgjithshme</i>	12
ii. <i>Përfjashtimet nga parimi i përgjithshëm</i>	12
iii. <i>Mjetet juridike</i>	12
B. Prezantimi i personave të dyshuar dhe akuzuar	19
i. <i>Parimet e përgjithshme</i>	18
C. Barra e Provës.....	21
i. <i>Parimet e përgjithshme</i>	21
ii. <i>Përfjashtimet nga parimet e përgjithshëm</i>	22
D. E drejta për të heshtur dhe për të mos u vet inkriminuar.....	24
i. <i>Parimet e përgjithshme</i>	24
ii. <i>Përfjashtimet nga parimi i përgjithshëm</i>	27
iii. <i>Mjetet juridike</i>	31
VI PËRDORIMI I DIREKTIVËS PARA AFATIT TË FUNDIT PËR TRANSPOZIMIN E SAJ	31
E. Jurisprudenca e GJDBE-së.....	32
F. Disa ide para afatit të fundit.....	33
VII. PËRFUNDIM	34

MANUALI MBI PREZUMIMIN E PAFAJËSISË

I. HYRJE

G. Historiku

1. Gjatë dekadës së fundit, shtetet anëtare të BE-së kanë bashkëpunuar ngushtë lidhur me çështjet ndërkufitare, kryesisht nëpërmjet mekanizmave për njohje të ndërsjellë, siç është Urdhër Arresti Evropian ('EAW'). Efikasiteti i mekanizmave të tillë varet nga besimi i ndërsjellë mes autoriteteve gjyqësore që secili do të respektojë të drejtat e personave relevant, në veçanti siç garantohen me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("KEDNJ").
2. Megjithatë, bashkëpunimi është dëmtuar nga fakti që autoritetet gjyqësore të cilat janë të thirrura të bashkëpunojnë me njëra-tjetrën, në realitet nuk kanë besim të plotë në njëri-tjetrin sa i përket respektimit të këtyre standardeve. Për të fuqizuar sistemin, BE-ja ka filluar vendosjen e standardeve minimale për rregullimin e aspekteve të caktuara të procedurës penale nëpërmjet një programi të quajtur "Udhërrëfyese i të Drejtave Procedurale (Procedural Rights Roadmap)".¹
3. Përderisa këto masa e kanë origjinën në sigurimin e besimit të ndërsjellë, rezultati nga kjo është një grup i direktivave që janë të detyrueshme për autoritetet kombëtare në gjitha rastet, duke përfshirë edhe direktivat pa ndonjë element ndërkufitar. Këto mbulojnë të drejtën për interpretim dhe përkthim,² të drejtën për informim,³ të drejtën për të pasur avokat, të drejtën për ndihmë juridike,⁴ të drejtën për prezumim të pafajësisë dhe pjesëmarrjes në gjykim⁵ dhe të drejtat e fëmijëve në procedura penale⁶ ("Direktivat Udhërrëfyese").

¹ Rezoluta e Këshillit e datës 30 nëntor 2009 mbi udhërrëfyese për fuqizimin e të drejtave procedurale të personave të dyshuar apo akuzuar në procedura penale ([OJ 2009 C 295, fq.1](#)).

² Direktiva 2010/64/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 20 tetor 2010 mbi të drejtën për interpretim dhe përkthim në procedura penale, ([OJ 2010 L 280, fq. 1](#)).

³ Direktiva 2012/13/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 maj 2012 mbi të drejtën për informim në procedura penale ([OJ 2012 L 142, fq. 1](#)).

⁴ Direktiva 2013/48/EU e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 22 tetor 2013 mbi të drejtën e qasjes në avokat në procedura penale dhe procedura të urdhërarrestit evropian dhe mbi të drejtën për informimin e palës së tretë pas privimit nga liria dhe komunikimit me personat e tretë dhe me autoritetet konsullore përderisa janë të privuar nga liria ([OJ 2013 L 290, fq. 1](#)).

⁵ Direktiva (BE) 2016/343 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 9 mars 2016 mbi fuqizimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtën për të marrë pjesë në gjykim në procedura penale, ([OJ 2016 L 65, fq. 1](#))

⁶ Direktiva (BE) 2016/800 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit e datës 11 maj 2016 mbi masat mbrojtëse procedurale për fëmijët që janë të dyshuar apo të akuzuar në procedura penale, ([OJ 2016 L 132, fq.1](#)).

4. Në këtë manual do diskutohet Direktiva 2016/343 mbi fuqizimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës për pjesëmarrje në gjykim në procedura penale (“**Direktiva**”). Prezumimi i pafajësisë është e drejtë themelore dhe element kyç që është në epiqendër të mbrojtjes së të drejtave për gjykim të drejtë sipas nenit 6 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“KEDNJ”) dhe nenit 48 të Kartës Evropiane për të Drejtat Themelore, si dhe Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Deklaratës Universale për të Drejtat e Njeriut dhe një numëri të traktateve dhe konventave tjera ndërkombëtare.
5. Direktiva mbulon të drejtën për t’u mos u paraqitur si fajtor nga autoritetet publike para marrjes së vendimit përfundimtar, kërkesa për barrën e provës të bie mbi prokurorinë dhe që çdo dyshim i arsyeshëm mbi fajësinë të jetë në favor të akuzuarit, si edhe të drejtën për të mos inkriminuar veten, të drejtën për të mos bashkëpunuar dhe të drejtën për të heshtur. Gjithashtu, kjo direktivë mbulon edhe të drejtën për të qenë i pranishëm në gjykim, por siç do të shpjegohet më poshtë, kjo pjesë e direktivës nuk do të adresohet në këtë manual.
6. Direktiva dallon nga udhërrëfyesi paraardhës për faktin se dispozitat e saj përcaktojnë parimet e përgjithshme të së drejtës, në vend se të ofrojnë kornizën procedurale për mbrojtjen e të drejtave të personave të dyshuar apo akuzuar në mënyrën që e gjejmë në direktivat e tjera udhërrëfyese. Kjo ngritë një numër të sfidave në lidhje me transpozimin dhe zbatimin efikas të direktivës, në veçanti pasi që shumica e shteteve anëtare tashmë e njohin dhe mbrojnë prezumimin e pafajësisë me ligj.⁷ Nga përvoja jonë, shtetet anëtare mund të mos shohin të nevojshme që të rishikojnë ligjet e tyre ekzistues dhe të ngurrojnë për reformimin e legjislacionit të tyre kombëtar. Për shembull, pas miratimit të Direktivës për të Drejtën për Informim, Qiproja nuk e amendamentoj ligjin e saj kombëtar që të jetë në përputhje me direktivën pasi që ligji ekzistues në Qipro tashmë përcaktonte disa nga të drejtat e përcaktuara në direktivë. Megjithatë, siç u dëshmuua më vonë, ligji ishte vetëm pjesërisht në përputhje me direktivën.⁸
7. Një ngurrim i tillë potencial nga ana e shteteve anëtare do të ishte veçanërisht shqetësues nën dritën e faktit që në Vlerësimin e Ndikimit të realizuar nga Komisioni Evropian para publikimit të propozimit të tij origjinal për direktivë u konstatua se në praktikë “mbrojtja e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë së personave të dyshuar dhe akuzuar në BE është e pamjaftueshme.”⁹ Në pikëpamjen e Komisionit Evropian “mbrojtja e parimit të prezumimit të pafajësisë nga Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut (“GJEDNJ”) ka rezultuar në mbrojtje të pamjaftueshme të personave të dyshuar apo akuzuar në BE.”
8. Kjo është theksuar nga Bordi Këshillëdhënës i LEAP gjatë takimit të organizuar në mars të vitit 2014 për të diskutuar propozimin e Komisionit Evropian për Direktivën. Bordi Këshillëdhënës

⁷ Dokumenti Punues i Stafit të Komisionit “Vlerësimi i Ndikimit”, shoqëron dokumentin “Propozim për masa për forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë prezent në gjykim në procedurën penale /*SWD/2013/0478 final*/, (“Vlerësimi i Ndikimit”), fq. 13, në dispozicion në: <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/HTML/?uri=CELEX:52013SC0478&from=en>.

⁸ <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/2017/05/Letters-of-Rights-International-and-Comparative-Law-Research-Report.pdf>

⁹ Vlerësimi i ndikimit, fq. 4.

theksoi që edhe kur kornizat ligjore në shumicën e shteteve anëtare i referohen parimit dhe përmbajnë dispozita që pasqyrojnë ato të direktivës, problemi kryesor qëndron në aplikimin jo koherent të këtyre normave në praktikë.¹⁰ Prandaj, është e qartë se në praktikë, mbrojtja e prezumimit të pafajësisë është nën pragun e direktivës. Duhet shqyrtuar nga afër legjislacionin kombëtar në mënyrë që të fuqizohet mbrojtja e të drejtës në praktikë. Për këtë arsye, zgjidhja është gjetja e një mjeti që ofron udhëzim për akterët, praktikantët, organizatat e shoqërisë civile dhe akterët tjerë relevant përgjatë periudhës para transpozimit në mënyrë që të sigurohet transpozimi dhe zbatimi efikas në përputhje me objektin dhe qëllimin e Direktivës.

9. Qëllimi i këtij manuali është të shërbejë si mjet që anëtarët e LEAP dhe avokatët e tjerë, OJQ-të, akademikët dhe palët e interesuara mund ta përdorin për të marrë informacione në mënyrë që të kontribuojnë në transpozimin adekuat të direktivës në ligjin kombëtar si dhe zbatimin efikas të saj. Përveç kësaj, në mënyrë që Direktivat Udhërrëfyese të kenë efektin e plotë, duhet të sigurohet që gjykatat kombëtare bazohen në ato. Për këtë arsye, ky manual gjithashtu do të identifikojë mënyrat në të cilat mund të përdoret direktiva nga gjykatat kombëtare edhe nëse nuk është transpozuar në legjislacionin kombëtar.

II. OBJEKTIVAT E KËTIJ MANUALI

10. Siç edhe u përmend më sipër, në kohën e publikimit të këtij manuali, afati i fundit për transpozim në ligjin kombëtar është pas një viti. Megjithatë, në shtetet anëtare që janë të obliguara të sigurojnë që direktiva është transpozuar në ligjin kombëtar deri më 1 prill të vitit 2018, shqyrtimi i ligjit kombëtar nga autoritetet kompetente për të vlerësuar përputhjen me direktivën duhet të bëhet vitin e ardhshëm, nëse tashmë nuk është në proces e sipër. “Fair Trails” do të punojë me anëtarët e LEAP dhe ekspertët e tjerë të drejtësisë penale për të siguruar që direktiva transpozohet dhe zbatohet në mënyrë efikase.
11. Ky Manual synon të ndihmojë lexuesit të identifikojnë fushat ku legjislacioni kombëtar aktual ose i propozuar nuk arrin të përmbushë kërkesat e Direktivës (lexohet së bashku me standardet e tjera ndërkombëtare) në mënyrë që këto të mund të adresohen në periudhën para transpozimit, duke lënë më pak probleme për trajtim nga gjykatat. Kjo është një mundësi interesante për praktikuesit, organizatat e shoqërisë civile dhe akterë tjerë që të përfshihen dhe të marrin pjesë në mënyrë aktive në procesin e transpozimit të Direktivës nëpërmjet reformës legislative dhe proceseve gjyqësore vendase.
12. Siç është paraqitur në raportin e “Fair Trials” të titulluar “Towards an EU Defence Rights Movement (Strategjitë për Zbatimin Efektiv të Direktivave Udhërrëfyese: Drejt Lëvizjes së BE-së mbi të Drejtën për t’u Mbrojtur)”,¹¹ në vitet e fundit, LEAP ka kontribuar në diskutimet legislative kombëtare në lidhje me zbatimin e Direktivave Udhërrëfyese. Në Lituani është marrë

¹⁰ LEAP, E drejtat e Mbrojtjes në Evropë: Rruga përpara, 2016, fq. 11, në dispozicion në: <https://www.fairtrials.org/defence-rights-in-europe-the-road-ahead/>

¹¹ LEAP, Strategjitë për Zbatimin Efektiv të Direktivave Udhërrëfyese: Drejt Lëvizjes së BE-së mbi të Drejtën për t’u Mbrojtur, 2015, para 29.

në konsideratë një parashtrësë e bërë nga Fair Trials' dhe anëtarët Lituanëz të LEAP, në konsultim me anëtarin e LEAP, Institutin për Monitorimin e të Drejtave të Njeriut dhe disa nga ndryshimet e rekomanduara janë përfshirë në tekstin përfundimtar legjislativ.¹² Në Spanjë, "Fair Trials" së bashku me "Rights International Spain" dhe disa OJQ tjera shkruan një letër të përbashkët, duke komentuar mbi draftin e masës legjislative që zbaton dy direktivat e para të udhërrëfyesit. Gjithashtu, "Fair Trials" punoi me "JUSTICE", anëtare e LEAP për Anglinë dhe Uellsin, me qëllim që të kontribuohet në konsultimin qeveritar mbi zbatimin e Direktivës mbi të Drejtën për Informim, me disa nga rekomandimet tona të pasqyruara në masat e aprovuara. Kjo tregon që mund të arrihet shumë në aspektin e sigurimit të zbatimit efikas të direktivës nëse LEAP dhe akterët tjerë përfshihen në mënyrë aktive në procesin e transpozimit.

13. Ky manual ofron një pasqyrë të dispozitave të direktivës në lidhje me prezumimin e pafajësisë dhe përmban një rishikim të praktikës gjyqësore relevante të GJEDNJ-së që do të ndihmojë në interpretimin e këtyre dispozitave. Duke pasur parasysh që direktiva ende nuk e ka arritur afatin e fundit për transpozimin e saj, akoma nuk ka efekt direkt në shtetet anëtare. Megjithatë, siç diskutohet në manualin "Përdorimi i të Drejtës së BE-së në Praktikën Penale" (Using EU Law in Criminal Practice Toolkit) të publikuar nga "Fair Trials" në vitin 2015, ekziston një numër i mënyrave në të cilat direktivat mund të përdoren për proces gjyqësor në këtë fazë.¹³ Prandaj, inkurajojmë anëtarët e LEAP që të lexojnë këtë manual së bashku me manualin "Përdorimi i të Drejtës së BE-së në Praktikën Penale".
14. Gjithashtu, ky manual ofron një sërë shembujsh të rasteve që tregojnë natyrën e situatave që në praktikë do të mund të përbënin shkelje të të drejtave të mbrojtura me direktivë. Qëllimi është të identifikohet lloji i situatave që bien brenda fushëveprimit të direktivës dhe që rrjedhimisht duhet të adresohen në ligjet aktuale apo të propozuara e të cilët e bëjnë transpozimin e direktivës.
15. "Fair Trials" dhe LEAP dëshirojnë të kuptojnë më mirë sfidat me të cilat përballen avokatët në praktikë gjatë mbrojtjes të së drejtës së klientëve të tyre që në faza të ndryshme të procedurave penale të prezumohen si të pafajshëm deri në dëshmimin e të kundërtës. Prandaj, për çdo aspekt të së drejtës për prezumim të pafajësisë të mbuluar në manual, kemi përfshirë një grup të pyetjeve sa i përket çështjeve të ndryshme që rrezikohen gjatë sigurimit të mbrojtjes efikase të së drejtës në fjalë në mënyrë që lexuesi të reflektojë mbi to. Kjo është diçka e re për të gjithë dhe jemi të interesuar të dëgjojmë se çka është duke funksionuar dhe çka jo, si janë duke reaguar politikë-bërësit, policia dhe gjykatat dhe çfarë suksesi jeni duke pasur në bazë të ideve dhe argumenteve të paraqitura në manualin tonë. Ne ftojmë anëtarët e LEAP që të fillojnë kontakte me "Fair Trials" për të ndarë përgjigjet dhe mendimet e mëtejshme. "Fair Trials" gjithashtu do të organizojë një seri të takimeve për të diskutuar këto çështje më në detaje.
16. Anëtarët e LEAP janë të vetëdijshëm se mund të arrijnë më shumë nëpërmjet partneriteteve dhe

¹² "Fair Trials" dhe LEAP, Shkresë tek Komiteti për Çështje Ligjore i Parlamentit të Lituanisë mbi transpozimin e Direktivës 2012/13/EU mbi të drejtën për informim në procedura penale, 2014, në dispozicion në:

<https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/Lithuania-Parliament-Submission-English1.pdf>

¹³ Shih manualin e 'Përdorimi i të Drejtës së BE-së në Manualin e Praktikës Penale' e "Fair Trials", 2014, fq. 12, në dispozicion në <https://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/Using-EU-law-A2L-FINAL1.pdf>

diskutimeve me akterët kyç lokal, si odat e avokatëve, policinë, gjyqësorin, universitetet dhe organet trajnuese. Në të vërtetë, shpresojmë që LEAP dhe të gjithë akterët brenda sistemeve ligjore kombëtare do mund të punojnë së bashku në hartimin e strategjive që janë specifike për vendin, në mënyrë që të adresohen sfidat e identifikuar si rezultat i pyetjeve të propozuara në këtë manual.

17. Në përmbledhje, objektivat e këtij manuali kanë të bëjnë me:

- A.** Ofrimin e një përmbledhje të dispozitave kryesore të direktivës në lidhje me praktikën gjyqësore të GJEDNJ;
- B.** Ofrimin e udhëzimit për mënyrën e përdorimit të direktivës gjatë periudhës para transpozimit;
- C.** Inkurajimin e anëtarëve të LEAP dhe rrjeteve të tyre për identifikimin e problemeve me ligjin dhe praktikën kombëtare që mund të adresohet nga direktiva; dhe
- D.** Ofrimin e një kornize për zhvillimin e strategjive për të ofruar informacione për reformën në ligj dhe praktikë, në mënyrë që direktiva të transpozohet dhe zbatohet në mënyrë efikase.

III. FUSHËVEPRIMI I MANUALIT

18. Ky manual mbulon aspektet e prezumimit të pafajësisë të identifikuar nga rrjeti i LEAP që përbëjnë një sfidë të veçantë në realizimin e mbrojtjes penale. Në këtë mënyrë, manuali fokusohet në (i) të drejtën për t'u mos u paraqitur si fajtor nga autoritetet publike para marrjes së vendimit përfundimtar, (ii) barra e provës bie mbi prokurorinë dhe dyshimet e arsyeshme mbi fajësinë duhet të jenë në favor të të akuzuarit, (iii) të drejtën për të mos inkriminuar veten, (iv) të drejtën për të mos bashkëpunuar, dhe (v) të drejtën për të heshtur. Ky manual nuk mbulon të drejtën për të qenë i pranishëm në gjykim.

IV. PËRMBLEDHJE E SHKURTËR E DIREKTIVËS

Dispozita	Çka mbulon	Aspektet e veçanta
Neni 1	Çështja lëndore	<ul style="list-style-type: none"> • Përcakton rregullat minimale të përbashkëta në lidhje me aspekte të caktuara të prezumimit të pafajësisë në procedurat penale.
Neni 2 Deklami met 12-15	Fushëveprimi	<ul style="list-style-type: none"> • Vlen për <u>personat fizik</u> që janë persona të dyshuar apo të akuzuar në procedura penale. Personat juridik nuk mbulohen nga direktiva. • Direktiva vlen për <u>të gjitha fazat e procedurave penale</u>, nga momenti kur personi dyshohet apo akuzohet se ka kryer një vepër penale deri në marrjen e vendimit mbi përcaktimin e fajësisë. • Kjo Direktivë ka fushëveprim më të gjerë kohore se sa direktivat paraprake udhërrëfyese, të cilat fillojnë vetëm nga momenti kur i dyshuari/akuzuari informohet që është si i dyshuar apo akuzuar.
Neni 3	Parimi i përgjithshëm i prezumimit të pafajësisë	<ul style="list-style-type: none"> • Shtetet anëtare sigurojnë që personat e dyshuar dhe të akuzuar prezumohen si të pafajshëm deri kur dëshmohen fajtorë sipas ligjit.
Neni 4 Deklami met 16-19	Referencimi publik si fajtor/e	<ul style="list-style-type: none"> • Autoritetet publike do përmbahen nga deklaratat publike që i referohen personave të dyshuar apo të akuzuar si fajtorë deri në dëshmimin e fajësisë së tyre sipas ligjit (1). • Ky obligim nuk paragjykon veprimet e prokurorisë që kanë për qëllim dëshmimin e fajësisë së personit të dyshuar apo të akuzuar dhe vendimet paraprake procedurale të marra nga autoritetet kompetente në bazë të dëshmive inkriminuese (1). • Autoritetet do të mund të shpërndajnë informatat mbi procedurat penale tek publiku vetëm kur një gjë e tillë është e nevojshme në mënyrë strikte për qëllim të hetimit penal apo në interes publik (3). • Mjetet juridike do jenë në dispozicion për shkeljet e obligimit për të mos iu referuar personave të dyshuar apo akuzuar si fajtorë (2).
Neni 5 Deklami met 20-21	Prezantimi i personave të dyshuar dhe akuzuar	<ul style="list-style-type: none"> • Personat e dyshuar apo akuzuar nuk prezantohen në gjykatë apo në publik si fajtorë nëpërmjet aplikimit të masave të kufizimeve fizike (1). • Masat e kufizimit fizik do të mund të aplikohen kur një gjë e tillë kërkohet për arsye që janë specifike për rastin, në lidhje me sigurinë apo për pengimin e

		arratisjes apo kontaktimin e personave të dyshuar apo akuzuar me personat e tretë (2).
Neni 6 Deklami met 22-23	Barra e provës	<ul style="list-style-type: none"> • Barra e provës për përcaktimin e fajësisë së personave të dyshuar dhe akuzuar bie mbi prokurorinë, pa marr parasysh obligimin e gjykatësit apo gjykatës për kërkimin e dëshmive fajësuese dhe shfajësuese dhe të drejtën e mbrojtjes për paraqitjen e dëshmive (1). • Çdo dyshim mbi fajësinë duhet të jetë në favor të personit të dyshuar apo akuzuar (<i>in dubio pro reo</i>) (2).
Neni 7 Deklami met 24-31	E drejta për të heshtur dhe për të inkriminuar veten	<ul style="list-style-type: none"> • Personat e dyshuar apo akuzuar kanë të drejtë të heshtin dhe të mos inkriminojnë veten (1) (2). • Kjo nuk i pengon autoritetet nga mbledhja e dëshmive, nëpërmjet kompetencave ligjore të detyrueshme, që kanë ekzistencë të pavarur nga vullneti i personave të dyshuar apo akuzuar (3). • Sjellja bashkëpunuese e personit të akuzuar duhet të merret parasysh në dënim (4). • Ushtrimi i kësaj të drejte nuk do të përdoret kundër personave të dyshuar apo akuzuar dhe nuk konsiderohet si dëshmi se ata e kanë kryer shkeljen e pretenduar (5). • Sa i përket kundërvajtjeve, shtetet anëtare mund të vendosin që procedurat të realizohen, pjesërisht apo tërësisht, me shkrim apo pa marrë në pyetje personin e dyshuar apo akuzuar, me kusht që kjo të jetë në përputhje me të drejtën për një gjykim të drejtë (6).
Neni 10 Deklami met 44-45	Mjetet juridike	<ul style="list-style-type: none"> • Personat e dyshuar dhe akuzuar duhet të kenë në dispozicion mjete efikase juridike nëse të drejtat e tyre sipas kësaj direktive shkelen (1). • Pa paragjykuar rregullat dhe sistemet kombëtare mbi pranueshmërinë e dëshmive, të drejtat e mbrojtjes dhe paanësisë së procedurave duhet të respektohen kur vlerësohen deklaratat e bëra nga personat e dyshuar apo akuzuar, apo dëshmitë e marra duke shkelur të drejtën për të heshtur apo të drejtën për të mos inkriminuar veten (2).

V. DISPOZITAT E DIREKTIVËS

A. Referimet publike në fajësi

i. Parimet e përgjithshme

19. Neni 4 i Direktivës, u ndalon autoriteteve publike të bëjnë deklarata publike që i referohen personave si fajtorë, përveç apo deri në dëshmimin e fajësisë sipas ligjit. Deklamimi 17 i direktivës përcakton termin “deklaratat publike të bëra nga autoritetet publike” si çdo deklaratë që i referohet një veprë penale e që jepet nga një autoritet i përfshirë në procedurat penale në fjalë si autoritetet gjyqësore, policia dhe autoritetet tjera për zbatimin e ligjit, apo nga ndonjë autoritet tjetër publik, si ministrat dhe zyrtarët tjerë publik, e.

Shembulli: Dan Grigoire Adamescu (Rumani)

Z. Adamescu, pronari i një gazete që kritikonte qeverinë e Rumanisë, u akuzua për korrupsion në Rumani. Gjatë procedurave paraprake, autoritetet gjyqësore bënë këto deklarata që nuk respektuan prezumimin e pafajësisë:

- Në vendimin për paraburgimin e z. Adamescu, gjykatësi iu referua “përmasave të veprave të paligjshme të kryera nga ai”, duke i përshkruar ato si fakte të vërtetuara në vend se si pretendime të padëshmuara.
- Në një seancë të apelit ku kundërshtojë mbajtja e tij, Gjykata e Kasacionit e citoi faktin se “i pandehuri [të pandehurit] vazhdon të mohojë kryerjen e krimeve për të cilat akuzohet dhe të kundërshtojë ekzistencën e dëshmive që arsyetojnë dyshimin e arsyeshëm që ata në fakt kanë kryer këto krime” si një nga arsyet kryesore për refuzimin e ankesës.

20. Neni 4 i direktivës mbulon deklaratat gjyqësore të bëra gjatë periudhës së procedurës paraprake, si në lidhje me vendimin për të urdhëruar paraburgimin apo për të revokuar lirimin në procedurën paraprake, të cilat portretizojnë të akuzuarin si fajtorë apo mbështeten në supozimin që i akuzuari ka kryer veprën penale në mënyra që tejkalojnë faktet e vërtetuara me dëshmi dhe nuk marrin parasysh mungesën e një dënimi të plotfuqishëm.

Nešták kundër Sllovakisë, nr. 65559/01, 27 shkurt 2007¹⁴

I dyshuari është arrestuar dhe marrë në pyetje lidhur me veprën penale të grabitjes. Gjatë marrjes në pyetje, i dyshuari u rrëfye për planifikimin dhe përgatitjen e grabitjes, por mohoi të ketë marrë pjesë në grabitje. Gjykata urdhëroi paraburgimin në bazë të dyshimit të fuqishëm që nëse lirohet, i akuzuari do të mund të kryente ndonjë vepër tjetër me qëllimin që të siguroj parat për të paguar një borxh financiar, gjë që e kishte shtyrë atë të planifikojë vjedhjen në rend të parë. I akuzuari bëri ankesë kundër vendimit. Gjykata rajonale hodhi poshtë ankesën dhe konstatoi që aplikanti

¹⁴ [Nešták v Slovakia](#), nr. 65559/01, 27 shkurt 2007.

ka pasur tendencë që të kryejë vepër dhe që rreziku që ai të kryejë vepra të mëtejshme akoma justifikohet. Ai kishte një borxh që nuk mund ta ri-paguante dhe sipas dëshmive në dispozicion, kjo ishte arsyeja pse ai kishte vendosur të kryejë grabitjen.

GJEDNJ konsideroi që kjo deklaratë e Gjykatës Rajonale e ka marrë si të dëshmuar që parashtruesi ka kryer veprën që i është ngarkuar, se motivi i tij ishte nevoja për para dhe mënyra në të cilën është kryer vepra ka treguar për nivelin e korrupsionit të parashtruesit. Prandaj, GJEDNJ konstatoi se këto deklarata përbëjnë shkelje të prezumimit të pafajësisë të të akuzuarit sepse kanë nënkuptuar qartë që individit kishte kryer krimin. Në mungesë të dënimit përfundimtar, fajësia e parashtruesit nuk ishte dëshmuar sipas ligjit dhe prandaj gjykatat është dashur të përmbahen nga referimi ndaj të dyshuarit në një mënyrë që sugjeron se ai ka kryer krimin në fjalë.

Allenet de Ribemont kundër Francës, 10 shkurt 1995, Seria A nr. 30815

Z. Allenet de Ribemont u arrestua në lidhje me veprën penale të vrasjes. Gjatë fazës hetimore, disa nga zyrtarët më të lartë në policinë franceze dhe Ministri i Punëve të Brendshme mbajtën një konferencë për shtyp në të cilën iu referuan qartë z. Allenet de Ribemont si një nga nxitësit dhe bashkëfajtorët në një vrasje të qëllimshme, pa kurrfarë kualifikimi apo rezervimi.

GJEDNJ konstatoi që këto deklarata kanë përbërë shkelje të nenit 6(2) të KEDNJ sepse “kjo ka qenë qartë deklaratë e fajësisë së aplikantit i cili së pari e ka inkurajuar publikun që të besojë në fajësinë e tij dhe së dyti ka paragjykuar vlerësimin e fakteve nga autoriteti kompetent gjyqësor.”

21. Jurisprudenca e GJENDJ është në harmoni me tekstin e direktivës. GJEDNJ ka përcaktuar që prezumimi i pafajësisë, i mbrojtur sipas nenit 6(2) të KEDNJ, do të shkelet nëse një vendim gjyqësor apo deklaratë e një zyrtari publik në lidhje me një person të akuzuar për vepër penale paraqet opinionin që ai është fajtor para se i njëjti të dëshmohet fajtor sipas ligjit. Edhe në mungesë të ndonjë konstatimi zyrtar, mjafton që ka arsye që sugjerojnë se gjykata apo zyrtari e konsiderojnë të akuzuarin si fajtor. Në rastin referues *Minelli kundër Zvicrës*, z. Minelli u ankua që gjykata zvicerane kishte megjithëse kishte ndërprerë procedurat kundër të akuzuarit për shkak të skadimit të afatit kohor për ndjekjen penale të një veprë, vendosi që z. Minelli duhet të bartë dy të tretat e kostos së procedurave për shkak se në mungesë të një afati të tillë kohor, dëshmia ekzistuese “me shumë gjasë se do të rezultonte me dënim” të të akuzuarit. Aplikanti u ankua se këto deklarata kanë shkelur të drejtën e tij për prezumim të pafajësisë. GJEDNJ u pajtua se, duke e përfshirë këtë deklaratë në arsyetimin e vendimit, gjykata zvicerane ka treguar se ka qenë e bindur me fajësinë e z. Minelli. Në mënyrë specifike, GJEDNJ vendosi që “pavarësisht nga mungesa e një konstatimi zyrtar dhe përkundër përdorimit të frazeologjisë së kujdesshme (‘sipas të gjitha gjasave’, ‘me shumë gjasë’), dhoma e gjykatës vazhdoi të bëjë vlerësime që nuk respektonin prezumimin e pafajësisë.”¹⁷

¹⁵ [Allenet de Ribemont v France](#), 10 shkurt 1995, Seria A nr. 308

¹⁶ [Minelli v Switzerland](#), 25 mars 1983, Seria A nr. 62.

22. Kriteret e vendosura nga GJEDNJ përcaktojnë që duhet të bëhet një dallim fundamental mes deklaratës se një person është thjesht i dyshuar se ka kryer një krim dhe deklaratës së qartë, në mungesë të dënimit përfundimtar, se një individ ka kryer krimin në fjalë.¹⁸ Në rastin *Lutz kundër Gjermanisë*,¹⁹ aplikanti u ankua lidhur me refuzimin e gjykatës gjermane për rimbursimin e kostove dhe shpenzimeve të tij të nevojshme pas ndërprerjes së procedurave penale kundër tij, e cila është justifikuar nga gjykata gjermane me deklarata që i referohen probabilitetit që i akuzuari ishte fajtor “sipas dosjes, i akuzuari me shumë gjasë se do të dënohej,” i akuzuari “pothuajse me siguri do të konstatohej fajtor për një vepër” dhe se “arsyet për urdhrin lidhur me kostot në vendimet e kundërshtuara janë [...] me të drejtë përkufizohen në konstatimin se i akuzuari me shumë gjasë se do të konstatohej fajtor”. Megjithatë, në këtë rast, GJEDNJ konstatoi se nuk ka pasur shkelje të nenit 6(2) të KEDNJ pasi që në bazë të dëshmisë, në veçanti në deklaratat e mëhershme të aplikantit ku pranohen faktet, termet e përdorura nga gjykatësit kanë përshkruar një gjendje të dyshimit në vend të konstatimit të fajësisë. GJEDNJ konsideroi se rasti dallonte nga *Minelli* ku gjykatat zvicerane urdhëruan që z. Minelli duhet të bartë kostot e procedurave dhe e urdhëruan atë të paguajë kompensimin për prokurorë privat në lidhje me shpenzimet e tyre, duke e trajtuar atë në këtë mënyrë si fajtor. Megjithatë, në rastin e z. Lutz, ai nuk është dashur të bartë kostot e procedurave, por vetëm kostot dhe shpenzimet e tij. Gjykatat gjermane, duke pasur parasysh dyshimet e fuqishme që sipas tyre kanë ekzistues ekzistuar në lidhje me të, nuk kanë shqiptuar ndonjë sanksion mbi të por thjesht refuzuan që të urdhërojnë që kostot dhe shpenzimet e nevojshme duhet të paguheshin nga fondet publike. Së fundmi, GJEDNJ vendosi që është praktikë e përcaktuar që neni 6(2) i KEDNJ nuk i obligon shtetet kontraktuese që në rast të ndërprerjes së ndjekjes penale të dëmshpërblejnë personin “të akuzuar me një vepër penale” për ndonjë dëm që ai mund të ketë vuajtur.²⁰

23. Kjo çështje është pranuar në rastin *Sekanina kundër Austrisë*.²¹

Sekanina kundër Austrisë, 25 gusht 1993, Seria A nr. 266-A

Sekanina u gjykua dhe u lirua për vrasjen e gruas së tij dhe pastaj inicioi procedurat për rimbursim të kostos dhe kompensim për më shumë se një vit të kaluar në paraburgim. Kërkesa për kompensim u hodh poshtë në bazë të asaj që lirimi i tij nuk ka larguar dyshimin se ai ka kryer vrasjen. Shteti i paditur argumentoi që indikacionet e dhëna nga gjykata kombëtare thjesht i referoheshin ekzistencës së vazhdueshme të dyshimit, që në vazhden e rastit *Lutz kundër Gjermanisë*, janë në përputhje me prezumimin e pafajësisë për aq sa nuk paraqesin opinionin se personi në fjalë është fajtor.

¹⁷ Po aty, para 38.

¹⁸ *Matijašević v Serbia*, nr. 23037/04, para 48, KEDNJ 2006-X.

¹⁹ *Lutz v Germany*, 25 gusht 1987, Seria A nr. 123

²⁰ Po aty, para 63.

²¹ *Sekanina v Austria*, 25 gusht 1993, Seria A nr. 266-A.

GJEDNJ në mënyrë unanime bëri dallimin mes rastit të mëhershëm të *Lutz*, i cili kishte të bëjë me ndërprerjen e procedurave para përcaktimit përfundimtar të fajësisë, ndërsa rasti aktual kishte të bëjë me procedurat pas lirimit nga akuza. GJEDNJ përcaktoi që “shprehja e dyshimeve në lidhje me pafajësinë e të akuzuarit është e mundshme përderisa procedura penale nuk është përfunduar me një vendim mbi meritat e akuzës. Megjithatë, nuk është e pranueshme që të mbështetemi në dyshime të tilla pasi vendimi bëhet i plotfuqishëm. Rrjedhimisht, arsyetimi [i gjykatave austriake] nuk është në përputhje me prezumimin e pafajësisë”.²² GJEDNJ konstatoi shkeljen e nenit 6(2) të KEDNJ.

24. Për dallim, GJEDNJ nuk konstatoi ndonjë shkelje në një rast shumë të ngjashëm, *Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar*.

***Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar* [GC], nr. 25424/09, KEDNJ 2013**

Aplikantja është dënuar për vrasje pa paramendim të fëmijës së saj. Më vonë, Gjykata e Apelit konstatoi që dëshmitë e reja do të mund të kishin ndikuar në vendimin e jurisë për dënimin e znj. Allen dhe ka liruar aplikanten. Prokuroria nuk kërkoi ri-gjykim duke pasur parasysh që në kohën kur znj. Allen paraqiti ankesë kundër dënimit të saj, ajo tashmë kishte vuajtur dënimin dhe kishte kaluar një periudhë e konsiderueshme kohore. Si rrjedhojë, kërkesa e saj për kompensim për gabim të drejtësisë u refuzua. Në arsyetimin e saj, Gjykata e Lartë theksoi që “për gjithçka [që Gjykata e Apelit] vendosi ishte se dëshmitë e reja kanë krijuar mundësinë që gjatë shqyrtimit së bashku me dëshmitë e dhëna gjatë gjykimit, juria mund të kishte liruar ankuesen. Kjo nuk arrin të demonstrojë përtej dyshimit të arsyeshëm që ka pasur gabim të drejtësisë në këtë rast.” Parashtruesja argumentoi që ky arsyetim i Gjykatës së Lartë ka shkelur të drejtën e saj për prezumim të pafajësisë.

GJEDNJ, në vazhden e rastit *Minelli, Lutz dhe Sekanina, inter alia*, theksoi që “shqyrtimi i praktikës gjyqësore të Gjykatës sipas nenit 6(2) [tregon] që nuk ka qasje të vetme në përcaktimin e rrethanave në të cilat neni do të shkelet në kontekstin e procedurave të cilat e pasojnë përfundimin e procedurave penale. Siç ilustron në praktikën ekzistuese gjyqësore të GJEDNJ, kjo varet shumë nga natyra dhe konteksti i procedurave në të cilat është marr vendimi i kundërshtuar.”

Megjithatë, GJEDNJ vendosi që lirimi i parashtrueses nuk është bazuar në meritat e rastit në kuptimin e vërtetë, për dallim nga *Sekanina*, ku lirimi është bazuar në parimin që çfarëdo dyshimi i arsyeshëm duhet të konsiderohet në favor të të akuzuarit. Në mënyrë specifike, GJEDNJ vendosi që “edhe pse zyrtarisht lirim nga fajësia, përfundimi i procedurave penale kundër parashtrueses mund të konsiderohet se ka më shumë veçori të një rasti në të cilin procedurat penale janë ndërprerë.”

Së dyti, GJEDNJ nuk e ka konsideruar që gjuha e përdorur nga gjykatat vendore e ka trajtuar aplikanten në një mënyrë që nuk është në përputhje me pafajësinë e saj. “Në vlerësimin nëse ka pasur ‘gabim të drejtësisë’, gjykatat nuk kanë komentuar nëse, në bazë të dëshmisë të ofruara në ankesë, aplikantja do të duhej apo kishte gjasë të lirohej apo dënohej, Ata nuk kanë komentuar nëse dëshmia tregonte fajësinë apo pafajësinë e aplikantes.”²³

²² Po aty, para 30.

²³ Po aty, para 134.

25. Në rastin *Allen kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ përcaktoi se “madje edhe përdorimi i gjuhës jo të përshtatshme mund të mos jetë vendimtar kur bëhet fjalë për natyrën dhe kontekstin e procedurave të veçanta”.²⁴ Prandaj, siç paraqitet më lartë, në mënyrë që të përcaktohet nëse deklarata e një autoriteti publik përbënë thjesht shprehje të dyshimit apo deklaratë të qartë që një individ ka kryer krimin në fjalë, GJEDNJ do të analizojë kontekstin e rrethanave të veçanta në të cilat është bërë deklarata e kundërshtuar.²⁵

Khuzhin dhe të tjerët kundër Rusisë, nr. 13470/02, 23 tetor 2008²⁶

Një person u ndalua dhe u akuzua për kidnapim dhe torturë. Disa ditë para hapjes së gjyqimit, një kanal i televizionit shtetëror transmetoi një program me hetuesin kryesor të rastit dhe prokurorin. Pjesëmarrësit diskutuan detajet e rastit dhe bënë disa deklarata në lidhje me natyrën e dhunshme të të akuzuarit dhe dhanë detaje për të kaluarën e tij kriminale. Ata iu referuan rrethanave në të cilat kishin ndodhur veprat penale si diçka që i akuzuari do ta bënte. Prokurori në mënyrë të veçantë theksoi që e vetmja zgjidhje që gjykata e rastit do të mund të bënte ishte dënimi në një masë të duhur. Derisa prezantuesi i emisionit deklaronte që i akuzuari shpejtë do të marrë dënimin që ai meriton, në ekran shfaqeshin fotografia e të akuzuarit dhe shkresa e lëndës. Më pas, programi u transmetua përsëri në dy raste gjatë gjyqimit dhe një herë tjetër disa ditë para seancës së apelit.

GJEDNJ konstatoi që hetuesi kryesor dhe prokurori kanë bërë deklarata që ishin përtej thjesht përshkrimit në pritje të procedurave apo gjendjes së dyshimit. Këto deklarata pa mëdyshje sugjeruan që i akuzuari ishte fajtor dhe paragjyquan vlerësimin e fakteve nga autoriteti kompetent gjyqësor. Duke pasur parasysh profilin e lartë të të dy pjesëmarrësve, deklaratat e tyre e inkurajuan publikun që të besojë se i akuzuari ishte fajtor para se të dënohej sipas ligjit. Prandaj, GJEDNJ konstatoi se ka pasur shkelje të së drejtës së akuzuarit për prezumim të pafajësisë.

Borovský kundër Sllovakisë, nr. 24528/02, 2 qershor 2009.

Në këtë rast, GJEDNJ konstatoi shkeljen e nenit 6(2) të KEDNJ si rezultat i shpërndarjes së detajeve specifike të dosjes së policisë në media, që e përshkruanin të akuzuarin si fajtor. Pretendimet e aplikantit i referoheshin publikimit të deklaratave nga zëvendës drejtori i Zyrës së Policisë Financiare në një gazetë ditore. Në veçanti, zyrtari policor theksoi që “veprimi i të akuzuarit, nëse konsiderohet në tërësi, ka qenë “veprimi i paramenduar mashtrues” që ka pasur qëllim transferimin e pronës së kompanisë në fjalë tek kompani të ndryshme.”

²⁴ *Allen v the United Kingdom* [GC], nr. 25424/09, para 126, ECHR 2013.

²⁵ *Borovský*, para 63.

Shih gjithashtu *Adolf v Austria*, 26 mars 1982, paras 36-44, Seria A nr. 49.

²⁶ *Khuzhin and Others v Russia*, nr. 13470/02, 23 tetor 2008.

Sipas pikëpamjes së GJEDNJ, kjo deklaratë nuk është kufizuar në përshkrimin e statusit në pritje të procedurave apo “gjendjes së dyshimit” kundër aplikantit, por ka dhënë një vlerësim të qëndrimit sikur ky të ishte një fakt i vërtetuar, duke e kualifikuar veprimin e personit të akuzuar si “mashtues” dhe sikur të “paramenduar”, pa kurrfarë rezervimi. Kjo deklaratë ka nënkuptuar që i akuzuari e kishte kryer krimin, dhe prandaj është konstatuar të jetë shkelje e nenit 6(2) të KEDNJ.

i. Përjashtimet nga parimi i përgjithshëm

26. Sipas nenit 4(1) të direktivës, ekzistojnë një numër i përjashtimeve në ndalimin e përgjithshëm të përmendur më lartë, si në lidhje me: 1) veprimet e prokurorit që kanë për qëllim të dëshmojnë fajësinë e individit (siç është ndjekja penale); dhe 2) vendimet paraprake procedurale nga autoritetet gjyqësore apo autoritetet tjera kompetente e të cilat bazohen në dyshim apo dëshmi inkriminuese (për shembull vendimi mbi paraburgimi). Përveç kësaj, neni 4(1) i Direktivës nuk i pengon autoritetet që ti ofrojnë publikut informata në lidhje me procedurat penale që janë duke u zhvilluar, kur kjo është e nevojshme në mënyrë strike për arsye që ndërlidhen me hetimin apo interesin publik. Për shembull, kjo përfshinë lëshimin e një video incizimi të të arratisurve që besohen se përbëjnë rrezik të pashmangshëm për publikun e përgjithshëm.
27. Këto obligime pasqyrojnë standardet tashmë të përcaktuara nga GJEDNJ, e cila në praktikën e saj gjyqësore ka theksuar nevojën që autoritetet të jenë të matura dhe të kujdesshme dhe të zgjedhin fjalët kur i japin informata publikut në mënyrë që të ruhet prezumimi i pafajësisë.²⁷
28. Shembuj të llojit të situatave në të cilat publikimi i informatave në lidhje me procedurat do të ishte e nevojshme në mënyrë strikte janë ofruar në Deklamimin 18 të Direktivës. Hetuesit mund të konsiderojnë se është e nevojshme në interesin e hetimit që të lëshojnë video materiale që i bëjnë thirrje publikut që të ndihmojë në identifikimin e kryesit të veprës penale. Përveç kësaj, informacionet mund të përhapen tek banorët e një zone të prekur nga një krim i pretenduar mjedisor në mënyrë që të ruhet siguria e publikut, dhe po ashtu prokuroria apo ndonjë autoritet tjetër kompetent mund të ofrojë informacione mbi gjendjen e procedurave penale në mënyrë që të parandalojë prishjen e rendit publik. Sipas Deklamimit 18 të Direktivës, informacionet e ofruara duhet të jenë objektive dhe të kufizuara në situatat në të cilat kjo do të mund të ishte e arsyeshme dhe proporcionale, duke marrë parasysh të gjitha interesat. Në çfarëdo rasti, mënyra dhe konteksti në të cilin informacionet përhapen nuk duhet të krijojnë përshtypjen se personi është fajtor para se ai apo ajo të jenë konstatuar si fajtor sipas ligjit.²⁸

i. Mjetet juridike

29. Sipas nenit 4(2), shtetet anëtare duhet të sigurohen se “mjetet e duhura” janë në dispozicion në rast të një shkelje të obligimit për të mos dhënë deklarata publike të cilat i referohen një personi si fajtor para se ai person të jetë konstatuar si fajtor në përputhje me ligjin.

²⁷ [Allen v the United Kingdom](#) [GC], nr. 25424/09, KEDNJ 2013.

²⁸ Deklamimi 18 i Direktivës.

Kjo duhet të lexohet në përputhje me nenin 10 të direktivës, sipas të cilit personat e dyshuar dhe akuzuar duhet të kenë mjete efikase juridike në rast të shkeljes së të drejtave të tyre sipas kësaj direktive. Në aspektin e mjeteve juridike, në direktivë nuk ka udhëzim mbi atë se çka kërkohet në mënyrë specifike, duke iu lënë shteteve anëtare të vendosin se cili do të ishte një mjet i duhur juridik në rast të shkeljes së nenit 4(1) të direktivës.

30. Vlerësimi i Ndikimit nga Komisioni Evropian konstatoi që përderisa vetëm pesë shtete anëtare kanë rregulla të veçanta që parashohin të drejtën për rekurs, shumica e shteteve anëtare nuk parashohin në ligjet e tyre kombëtare mjete specifike juridike për shkeljet e ndalimit për të bërë referime publike të fajësisë. Megjithatë, edhe pse nuk kanë mjete specifike juridike, disa forma të kompensimit nëpërmjet të drejtës për ankesë apo kompensim financiar janë në dispozicion në të gjitha shteteve anëtare.²⁹
31. GJEDNJ në mënyrë të vazhdueshme ka vendosur që forma më e përshtatshme e kompensimit për shkeljen e të drejtës për gjykim të drejtë është të sigurohet, për aq sa shumë e mundur, që personat e dyshuar apo të akuzuar të vendosen në një pozitë ku të drejtat e tyre nuk shpërfillen.³⁰ Megjithatë, kjo qasje kompensuese ndryshon varësisht nga natyra e shkeljes në fjalë. Për shembull, në rastet e referimeve publike të fajësisë, nuk ka ndonjë dëshmi që do të mund të përjashtohet; prandaj, një mjet i përshtatshëm juridik do të mund të ishte urdhri për rigjykim së bashku me masat tjera, si tërheqja publike e një deklaratë të tillë, largimi i personelit të caktuar (qoftë gjyqësor apo prokurorial) nga rasti apo ndryshimi i vendit të gjykimit. Faza në të cilën shkelja identifikohet dhe ushtrohet ankesë ndaj saj duhet gjithashtu të ofrojë informata mbi llojin e mjetit juridik që është i përshtatshëm për shkeljet e këtij aspekti të prezumimit të pafajësisë. Sa më herët që zbulohet shkelja e nenit 6(2) të KEDNJ, aq më shumë ka gjasa që do të mund rregullohet brenda rrjedhës së hetimit. Rezultati i procedurave gjyqësore është po ashtu i rëndësishëm duke pasur parasysh se shkelja e ndalimit për prononcime publike mund të kërkojë një mjet ligjor në rast të lirimit nga akuza.

Pyetjet para-transpozimit

A ndalohen me ligj referimet publike ndaj fajit nga autoritetet gjyqësore dhe autoritetet për zbatimin e ligjit në juridiksionin tuaj? Nëse po, cilat mjete juridike janë në dispozicion kur bëhen referime të tilla publike?

Nga përvoja juaj, a janë referimet publike në fajësi problem në juridiksionin tuaj? A keni punuar ndonjëherë në ndonjë rast në të cilin janë bërë referenca ndaj fajësisë?

A nevojitet reforma legjislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që Direktiva transpozohet në mënyrë të duhur? A ka ndonjë zgjidhje tjetër jo legjislative për problemet që i shihni në praktikë në lidhje me referimet publike në fajësi?

A ka ndonjë pyetje që lidhet me ndalimin e referimit publik në fajësi për të cilën mendoni se do ishte e dobishme të kërkohej sqarim nga GJDBE?

²⁹ "Vlerësimi i Ndikimit", supra n 7, fq. 20

³⁰ Shih [Salduz v Turkey](#) [GC], nr. 36391/02, KEDNJ 2008

H. Prezantimi i personave të dyshuar dhe akuzuar

i. Parimet e përgjithshme

Nenit 5 i Direktivës përcakton se shtetet anëtare “do ndërmarrin masat e duhura për të siguruar që personat e dyshuar dhe ata të akuzuar nuk paraqiten si të fajshëm përmes përdorimit të masave të kufizimit fizik” në gjykatë apo në publik. Kjo dispozitë ishte përfshirë në tekstin final të Direktivës pas sugjerimeve të bëra nga LEAP në një dokument mbi qëndrimin.³¹ LEAP sugjeroi që një formulim i ri që u kërkon shteteve anëtare të sigurojnë se të dyshuarit “nuk prezantohen në gjykatë apo në media në një mënyrë që sugjeron fajësinë e tyre, veçanërisht me rroba burgu, me pranga në duar apo përdorimi i grilave në sallën e gjykatës,” përveç nëse një gjë e tillë arsyetohet me shqetësime specifike për sigurinë. Kjo ishte përgjigje për anëtarët e LEAP në MB, të cilët shprehën shqetësimin lidhur me përdorimin e “bankës së të akuzuarit” – gjegjësisht një kutie prej xhami ku të dyshuarit ulen në gjykatë, zakonisht së bashku me policinë – dhe shqetësimet e shprehura nga avokatët nga Luksemburgu lidhur me përdorimin sistematik të prangave në sallat e gjykatës.³² Parlamenti Evropian ka pranuar disa nga sugjerimet e LEAP, duke përfshirë pikën mbi prezantimin e të akuzuarit në formulim që është pothuajse identik me atë të propozuar nga LEAP në brifingjet e tij.³³

Shembull nga anëtari i LEAP në Luksemburg

Tre burra të akuzuar për një krim të rëndë janë mbajtur me pranga në duar dhe në një “kuti” xhami përgjatë gjithë gjykimit të tyre. Prangat u ishin hequr nga duart vetëm kur të dyshuarit dëshmuuan.

Përkundër protestimit të avokatit të të dyshuarve mbi përdorimin e prangave në duar edhe përkundër mos-ekzistimit të indiceve të dhunës nga ana e të dyshuarve përveç natyrës së pretendimeve, dhe pavarësisht prezencës së vazhdueshme të policisë në sallën e gjykatës për të garantuar sigurinë, gjykatësi dhe policia refuzuan, duke marrë qëndrimin se çdo i dyshuar i ndaluar duhet të mbahet me pranga në duar në gjykatë, pa përcaktimet individuale për domosdoshmërinë e tyre.

32. Siç shpjegohet më tej në nenin 6(2) dhe Deklamimin 20 të direktivës, masat e tilla si prangat në duar, kutitë e xhamit, kafazet dhe prangat në këmbë duhet të aprovohen në baza specifike për rastin. Kjo nënkupton që masat e kufizimit fizik duhet të shmangen, përveç nëse përdorimi i tyre kërkohet për të penguar personat e dyshuar apo akuzuar që të mos lëndojnë veten apo të tjerët; dëmtimin e pronës; arratisjen; apo kontaktin me personat e tretë apo dëshmitarët.³⁴

³¹ “Fair Trials” dhe LEAP, Dokumenti i përbashkët i qëndrimeve mbi Direktivën e propozuar për forcimin e disa aspekteve të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim në procedimet penale, nëntor 2014, në dispozicion në: <https://www.fairtrials.org/ep-content/uploads/Presumption-of-Innocence-PositionPaper2.pdf>.

³² JUSTICE, In the Dock – Reassessing the use of the dock in criminal trials, 2015, në dispozicion në: <http://justice.org.uk/ep-content/uploads/2015/07/JUSTICE-In-the-Dock.pdf>.

³³ Qëndrimi i Parlamentit Evropian, i miratuar në leximin e parë më 20 janar 2016 me qëllim të miratimit të direktivës së Parlamentit Evropian dhe të Këshillit mbi fuqizimin e aspekteve të caktuara të prezumimit të pafajësisë dhe të së drejtës për të qenë i pranishëm në gjykim në procedurat penale, në dispozicion në: <http://www.europarl.europa.eu/sides/getDoc.do?pubRef=-//EP//NONSGML+TC+P8-TC1-COD-2013-0407+0+DOC+PDF+V0//EN>

³⁴ Deklamimi 20 i direktivës.

Kjo duhet të interpretohet sikur vendosje e kërkesës për vlerësim të rrethanave të veçanta të secilit rast. Vetëm kur është e përcaktuar se në një rast të veçantë ekziston rreziku real ndaj sigurisë nga i akuzuari, apo është dëshmuar se ekzistojnë arsye të fuqishme për të besuar se i akuzuari ka gjasa të arratiset apo do të provojë të kontaktojë personat e tretë, vendimi për miratimin e këtij lloji të masave do të mund të ishte i justifikueshëm.

33. Direktiva bazohet në jurisprudencën e GJEDNJ, e cila ka konfirmuar se përdorimi i “bankës së të akuzuarit”, kafazeve metalike apo kutive të xhamit gjatë procedurave ligjore shkel të drejtat e personit të akuzuar.³⁵ Megjithatë, GJEDNJ paraprakisht ka konstatuar që masat e tilla shkelin të drejtën e të akuzuarit për të mos përjetuar trajtim degradues sipas nenit 3 të GJEDNJ në vend të prezumimin e pafajësisë sipas nenit 6(2) të KEDNJ.³⁶ Përveç kësaj, GJEDNJ ka konstatuar se përdorimi i bankave të të akuzuarve, kutive prej xhami dhe kafazeve shkel nenet 6(1) dhe 6(3) të KEDNJ për aq sa veprojnë si barriera fizike që dëmtojnë aftësinë e të akuzuarit për të marrë pjesë seancën dëgjimore dhe përbëjnë ndërhyrje me të drejtën e tij për të marrë ndihme efikase juridike.³⁷

Rasti *Ramishvili and Kokhreidze v Georgia*, nr. 1704/06, 27 janar 2009

Gjatë procedurës gjyqësore, aplikantët ishin mbajtur në kafaze metalike, të rrethuar nga rojet e frikshëm, të maskuar dhe të armatosur. Ata pohonin se ishin ekspozuar para publikut si kriminelë dhe se një trajtim i tillë ishte degradues. Një video-incizim i seancës u transmetua drejtpërdrejt dhe disa fotografi u realizuan në sallën e gjyqit.

GJEDNJ-ja konstatoi se një paraqitje e tillë e ashpër dhe armiqësore e procedurave gjyqësore mund të shtynte një vëzhgues të zakonshëm të besojë se po gjykohen "kriminelë jashtëzakonisht të rrezikshëm", gjë që më pas dëmtoi parimin e prezumimit të pafajësisë. Përveç kësaj, trajtimi në sallën e gjyqit i poshtëroi parashtruesit në sytë e tyre dhe në sytë e publikut.

GJEDNJ-ja vuri në dukje se Qeveria nuk kishte dhënë asnjë justifikim për paraqitjen e parashtruesit në atë mënyrë. Gjykata u shpreh se vendosja e masave të tilla të rrepta dhe poshtëruese ndaj ankuesve nuk ishte e justifikuar dhe për këtë arsye konstatoi se kishte pasur shkelje të nenit 3 të KEDNJ-së.

34. Në këtë aspekt, direktiva shkon një hap më tej se GJEDNJ-ja duke e bërë shumë të qartë se masat e kufizimit fizik bien ndesh me prezumimin e pafajësisë kur zbatohen me justifikim të pamjaftueshëm dhe duke mos i marrë parasysh rrethanat specifike të rastit.
35. Sipas Deklamimit 21 të direktivës, të dyshuarit ose të akuzuarit nuk duhet të paraqiten në gjykatë ose në publik të veshur me rroba burgu kur kjo do të jepte përshtypjen se personi është fajtor.³⁸ Kjo dispozitë reflekton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së, e cila ka konstatuar shkelje të nenit 6(2) të KEDNJ-së kur të dyshuarit ose të akuzuarit paraqiten në gjykim të veshur me rroba burgu në rastet kur nuk është dhënë justifikim i mjaftueshëm nga shteti i paditur. Kjo është një çështje

³⁵ *Ramishvili and Kokhreidze v Georgia*, nr. 1704/06, para 100, 27 Janar 2009

³⁶ *Ibid*, paras 96-102

³⁷ [Yaroslav Belousov v Russia](#), nos 2653/13 dhe 60980/14, paras 145-154, 4 tetor 2016

³⁸ Deklamimi 21, direktiva.

ku GJEDNJ-ja ka qenë më e vendosur në përcaktimin e sjelljes së tillë si shkelje të prezumimit të pafajësisë sipas nenit 6(2) të KEDNJ-së, për dallim nga masat tjera të kufizimit fizik (p.sh. kabina xhami, kafaze etj.), të cilat, siç është cekur më lart, në përgjithësi shihen nga GJEDNJ-ja si shkelje të nenit 6(1) dhe nenit 3 të KEDNJ-së.

Rasti *Samoilă and Cionca v Romania*, nr. 33065/03, §§99-101, 4 mars 2008³⁹,

Aplikanti ishte paraqitur në gjykatë me rroba burgu që janë specifike për personat e dënuar. Qeveria pohoi se ishte vetëm një masë administrative dhe parandaluese për të siguruar higjienën e të burgosurve, që nuk mund të kishte efektin e ndikimit në paanshmërinë e gjyqtarëve. GJEDNJ-ja konstatoi se duke pasur parasysh faktin se nuk është dëshmuar se aplikantët nuk kanë pasur rroba të duhura, praktika e tillë ishte pa asnjë justifikim dhe kishte mundësi të forconte opinionin publik për fajësinë e parashtruesve. Prandaj, aty ka pasur shkelje të nenit 6(2) të KEDNJ-së.

Rasti *Jiga v Romania*, nr. 14352/04, §§101-103, 16 mars 2010⁴⁰,

Parashtruesi u detyrua të paraqitej para gjykatës i veshur me rroba burgu që ishin specifike për personat që ishin dënuar, pavarësisht se i kishte rrobat e tij të cilat mund t'i veshte. Ai u shoqërua në sallën e gjyqit duke qenë i prangosur. Për dallim nga ai, i akuzuari tjetër që ishte me të u lejua t'i veshë rrobat e tij. Shtetet e paditura u munduan ta justifikonin paraqitjen e të akuzuarit në uniformën e burgut duke pretenduar se një gjë e tillë ishte e nevojshme duke qenë se personi në fjalë nuk kishte rrobat e tij.

GJEDNJ-ja vuri në dukje se Qeveria nuk kishte demonstruar mjaftueshëm domosdoshmërinë e masës, e cila, sipas mendimit të saj, sugjeroi që urdhri që parashtruesi të paraqitej në rroba burgu nuk kishte asnjë justifikim. GJEDNJ-ja konstatoi se paraqitja e të akuzuarit tjetër në rrobat e tij kishte qenë veçanërisht e dëmshme për parashtruesin pasi kishte gjasa t'i jepte publikut përshtypjen se ai ishte fajtori. Prandaj, GJEDNJ-ja konstatoi këtu një shkelje të prezumimit të pafajësisë.

Pyetjet në lidhje me periudhën para transpozimit

A ka dispozita ligjore në juridiksionin tuaj që rregullojnë mënyrën se si të dyshuarit dhe të akuzuarit mund të paraqiten në gjykatë, në publik dhe në media? Nëse po, cilat janë mjetet juridike në dispozicion kur një i dyshuar ose i akuzuar paraqitet sikur të ishte fajtor?

Në bazë të përvojës tuaj, a është paraqitja e të dyshuarve dhe e të akuzuarve si fajtorë problem i veçantë në juridiksionin tuaj? Cilat masa të vetëpërmbajtjes, nëse ka, përdoren në mënyrë rutinore? A keni punuar ndonjëherë në ndonjë rast në të cilin klienti juaj është paraqitur si fajtor dhe ku mendoni se është dëmtuar prezumimi i pafajësisë?

³⁹ Rasti [Samoilă and Cionca v Romania](#), nr. 33065/03, paragrafët 99-101, 4 mars 2008.

⁴⁰ Rasti [Jiga v Romania](#), nr. 14352/04, paragrafët 101-103, 16 mars 2010

A është e nevojshme reforma legislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate sa i përket paraqitjes së të akuzuarit? A ka ndonjë zgjidhje jo-legislative për problemet që shihni në praktikë në lidhje me paraqitjen e të akuzuarit? A ka ndonjë pyetje në lidhje me paraqitjen e të akuzuarit, për të cilën mendoni se është e dobishme të kërkohet nga GJDBE-ja të ofrojë sqarime në lidhje me të?

Projekti i ri i "Fair Trials"

"Rëndësia e paraqitjeve: si paraqiten të dyshuarit dhe të akuzuarit në sallën e gjyqit, në publik dhe në media"

"Fair Trials", së bashku me Komitetin Hungarez të Helsinkit, së fundmi kanë zhvilluar një projekt që synon të sigurojë zbatimin korrekt të direktivës përmes reduktimit të numrit të rasteve ku të dyshuarit dhe të akuzuarit paraqiten në gjykatë ose në publik, madje edhe përmes medias, në mënyra që krijojnë një perceptim të fajësisë.

Ky projekt synon t'i zgjerojë njohuritë në dispozicion për përdorimin e masave kufizuese ndaj të dyshuarve dhe të akuzuarve në gjykatë ose në publik, si dhe nivelin në të cilën zyrtarët publikë respektojnë prezumimin e pafajësisë në komunikimet e tyre publike. Ai synon t'i identifikojë dhe shpërndajë praktikatat e mira të transferueshme në lidhje me përdorimin e kufizimeve fizike ndaj të dyshuarve dhe të akuzuarve në gjykatë dhe në publik dhe se si të komunikohet me mediat në lidhje me hetimet ose ndjekjet penale të vazhdueshme, pa shkelur prezumimin e pafajësisë. Së fundmi, projekti do të përqendrohet në sensibilizimin e autoriteteve publike, medias dhe publikut të gjerë mbi rëndësinë e mënyrës në të cilën një i dyshuar ose i akuzuar paraqitet në gjykatë ose në media dhe thekson mënyrat në të cilat praktikatat e ndryshme mund të rrisin ose ulin perceptimet e fajësisë.

Ju lutemi [kontaktoni](#) "Fair Trials" nëse dëshironi të mësoni më shumë se si të kontribuoni në këtë projekt.

I. Barra e provës

i. Parimet e përgjithshme

36. Sipas nenit 6 të direktivës, Shtetet Anëtare janë të obliguara të "sigurojnë që barra e provës për vërtetimin e fajësisë së të dyshuarve dhe të akuzuarve bie mbi prokurorinë". Ai thekson gjithashtu se "kjo zbatohet pa cenuar ndonjë detyrim të gjyqtarit ose gjykatës kompetente që të kërkojë dëshmi fajësuese dhe shfajësuese, si dhe pa cenuar të drejtën e mbrojtjes që të paraqesë dëshmi në përputhje me ligjin e zbatueshëm kombëtar". Në fund, neni 6(2) i direktivës parasheh që "çfarëdo dyshimi mbi fajësinë është në dobi të të dyshuarit ose të akuzuarit, përfshirë edhe me rastin e vlerësimit nga Gjykata mbi atë nëse personi në fjalë duhet të lirohet nga akuzat."⁴¹

⁴¹ Neni 6, direktiva.

37. Direktiva pasqyron jurisprudencën e GJEDNJ-së, e cila në rastin *Barberà, Messegué dhe Jabardo v Spain* konstatoi se neni 6(2) i KEDNJ-së kërkon, mes tjerash, që barra e provës të bie mbi prokurorinë, dhe çdo dyshim duhet të jetë në dobi të të akuzuarit.⁴² GJEDNJ ka sqaruar më tej se parimi kërkon që prokuroria të informojë të akuzuarin për rastin që do të bëhet kundër tij, në mënyrë që ai të përgatisë dhe të paraqesë mbrojtjen e tij në përputhje me rrethanat, dhe kërkon që prokuroria të paraqesë dëshmi të mjaftueshme për ta dënuar atë.⁴³

ii. *Përjashtimet nga parimet e përgjithshme*

38. Deklamimi 22 i direktivës përcakton përjashtimet e mëposhtme nga parimi se barra e provës bie mbi prokurorinë:

- i. çdo kompetencë ex officio e gjykatës për gjetjen e fakteve, përkatësisht çdo vendim i gjyqtarëve për të miratuar masa në kërkim të dëshmive fajësuese ose shfajësuese;
- ii. pavarësia e gjyqësorit në vlerësimin e dëshmive ekzistuese për përcaktimin e fajësisë së të akuzuarit; dhe
- iii. prezumimet e faktit apo ligjit lidhur me përgjegjësinë penale të një të dyshuari apo të akuzuari.

39. Prezumimet e faktit apo ligjit ekzistojnë në çdo sistem të së drejtës penale dhe kryesisht zbatohen në shkeljet ligjore që lidhen me trafikun, drogën dhe taksat. Shtetet anëtare mund të penalizojnë një fakt të thjeshtë ose objektiv si të tillë, pavarësisht nëse rezulton nga qëllimi kriminal apo nga neglizhenca (d.m.th. nëse një person është gjetur se posedon drogë në një aeroport, atëherë mund të zbatohet prezumimi për qëllime të kontrabandës). Megjithatë, këto prezumime duhet të kufizohen brenda kufijve të arsyeshëm. Për shembull, direktiva përcakton se ato duhet të jenë të kundërshtueshme, që do të thotë se të akuzuarit duhet t'i jepet mundësia që t'i kundërshtojë dhe që të paraqesë dëshmi shfajësuese. Përveç kësaj, prezumimet e faktit apo ligjit duhet të zbatohen duke respektuar siç duhet të drejtat e mbrojtjes në çdo rast dhe duke marrë parasysh rëndësinë e asaj që është në rrezik. Kjo do të thotë se gjatë zbatimit të prezumimeve të faktit dhe ligjit, shtetet anëtare duhet të shqyrtojnë nëse mjetet e përdorura janë arsyeshëm proporcionale me qëllimin legjitim që synohet të arrihet.

40. Ngjashëm si direktiva, as GJEDNJ-ja nuk e ka konsideruar këtë si parim absolut. Përkundrazi, ajo lejon zbatimin e prezumimeve ligjore të faktit ose të ligjit. Në rastin *Salabiaku v France*, GJEDNJ-ja vendosi që barra e provës mund të zhvendoset tek mbrojtja por rëndësia e asaj që është në rrezik dhe masat mbrojtëse që ekzistojnë për t'i mbrojtur të drejtat e mbrojtjes duhet të merren parasysh kur përcaktohet nëse barra e bartur e provës është e pranueshme apo jo.⁴⁴

Rasti *Salabiaku v France*, 7 tetor 1988, seria A nr. 141-A

Në këtë rast, nga GJEDNJ-ja u kërkua që të shqyrtojë pajtueshmërinë me nenin 6(2) të KEDNJ-së të një ligji që bartë barrën e provës tek mbrojtja në lidhje me disa elemente të një vepre penale. Parashtruesi ishte gjetur në posedim të drogave ilegale në një aeroport të Parisit. Në gjykim dhe në apel ai u dënua për kontrabandë, që përfshin elementin edhe të dijenisë ose qëllimit. Kodi Doganor francez që përcakton veprat penale parashih përgjithësisht se "personi në posedim të

⁴² Rasti *Barberà, Messegué and Jabardo v Spain*, 6 dhjetor 1988, paragrafi 77, seria A nr. 146.

⁴³ Po aty.

⁴⁴ Rasti *Salabiaku v France*, 7 tetor 1988, seria A nr. 141-A

kontrabandës konsiderohet përgjegjës për veprën penale" dhe se i akuzuari mund të shfajësojë veten duke vërtetuar forcën madhore (*force majeure*) që rezulton "nga një përgjegjësi apo ngjarje e cila nuk i atribuohet atij dhe të cilën e kishte absolutisht të pamundur që të shmangte". Shteti i përkatës konsideroi se sipas Kodit Doganor vepra penale është kryer në bazë të "faktit ("objektiv") të thjeshtë" të "posedimit të mallrave të ndaluara gjatë kalimit nëpër doganë", "pa qenë e nevojshme të përcaktohet qëllimi mashtrues ose neglizhenca" nga ana e "personit në posedim". I mbeti Prokurorit Publik që të ofrojë prova për këtë fakt. Shteti i përkatës argumentonte se Kodi Doganor nuk ka përcaktuar një prezumim të pakundërshtueshëm të fajësisë, por "një prezumim të kundërshtueshëm të faktit dhe përgjegjësisë". Për Qeverinë, kjo nënkuptonte më shumë "ndarjen" e barrës së provës dhe assesi "bartjen" e saj.

GJEDNJ-ja në mënyrë specifike vuri në dukje se prezumimet e faktit apo të ligjit veprojnë në çdo sistem ligjor dhe se në parim këto prezumime nuk janë të ndaluara sipas KEDNJ-së. Megjithatë, GJEDNJ-ja konstatoi se KEDNJ-ja nuk i obligon shtetet të mbesin brenda kufizimeve të caktuara. Më pas, detyra e GJEDNJ-së ishte të shqyrtojë nëse këto kufizime u tejkaluan në dëm të z. Salabiakut.

GJEDNJ-ja gjeti se gjykata kombëtare theksoi faktin që i akuzuari "nuk shfaqti habi" kur pa se pako e parë e hapur në praninë e tij përmbante drogë. Sipas gjykatës kombëtare, ky qëndrim përcaktoi "keqbesimin" e parashtruesit dhe konsideroi se kishte "prezumime[...] mjaftueshëm serioze, të sakta dhe të pajtueshme për të arsyetuar dënimin". Gjykata e Apelit vuri në dukje se parashtruesi "po kalonte përmes doganës me bagazhin dhe u kishte deklaruar zyrtarëve doganorë se ishte pronë e tij". Si rezultat i kësaj, gjykata kombëtare konsideroi se mund të nxirrej një konkluzion se ai kishte për qëllim kryerjen e veprës penale të kontrabandës.

GJEDNJ-ja konkludoi se prezumimi i krijuar nga Kodi Doganor dhe i aplikuar ndaj parashtruesit nuk ishte i pakundërshtueshëm. Ajo konstatoi se gjykatat kombëtare kishin ndjekur praktikën gjyqësore sipas së cilës, pasi prokuroria kishte përcaktuar faktin e posedimit, barra u zhvendos tek mbrojtja për të dëshmuar se i akuzuari nuk ka mund të jetë në dijeni për mallrat në posedim të tij. Gjykatat kombëtare kishin shqyrtuar të gjitha dëshmitë dhe e kishin gjetur atë fajtor pa u mbështetur në prezumimin ligjor. Për këtë arsye, **GJEDNJ-ja konstatoi se nuk kishte shkelje të nenit 6(2) të KEDNJ-së**.

Rasti *Telfner v Austria*, nr. 33501/96, 20 mars 2001⁴⁵

Në këtë rast, aplikanti u dënua për një vepër penale që përfshinte një aksident trafiku ku vozitësi kishte shkaktuar aksident dhe ishte larguar. Ai zgjodhi të heshte dhe prokuroria u mbështet plotësisht në gjetjet e policisë se aplikanti, i cili në kohën e aksidentit nuk ishte në shtëpi, është përdoruesi kryesor i veturës.

GJEDNJ-ja konstatoi se prokuroria e kishte ndërtuar rastin e saj duke u mbështetur në dëshmi shumë të dobëta kundër të akuzuarit dhe nuk arriti të dëshmonte në vetvete se ai kishte kryer veprën penale.⁴⁶ Prandaj, kur Gjykata kërkoi nga aplikanti që të ofrojë një shpjegim pa e ndërtuar

⁴⁵ Rasti *Telfner v Austria*, nr. 33501/96, 20 mars 2001.

⁴⁶ Po aty, paragrafi 17.

fillimisht një rast bindës kundër tij, gjykata kombëtare në fakt zhvendosi barrën e provës nga prokuroria tek mbrojtja, gjë që shkaktoi shkelje të nenit 6(2) të KEDNJ-së.⁴⁷

Pyetjet në lidhje me periudhën para transpozimit

A është e rregulluar me ligj barra e provës në çështjet penale në juridiksionin tuaj? Cilat mjete, nëse ka ndonjë, ekzistojnë në ligj për shkeljet që lidhen me dështimin e autoriteteve që të sigurojnë që barra e provës të bie mbi prokurorinë?

A mendoni se ka probleme të veçanta në lidhje me bartjen e barrës së provës në juridiksionin tuaj? Në cilat raste ndodh kjo? A keni punuar ndonjëherë në një rast ku kjo ka ndodhur?

A është e nevojshme reforma legislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate në lidhje me barrën e provës? A ka ndonjë zgjidhje tjetër jo-legjislative për problemet që shihni në praktikë në lidhje me barrën e provës?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me barrën e provës, për të cilën mendoni se është e dobishme të kërkohet nga GJDBE-ja të ofrojë sqarime në lidhje me të?

J. E drejta për të heshtur dhe për të mos u vet inkriminuar

i. Parimi i përgjithshëm

41. Neni 7 i direktivës kërkon që shtetet anëtare të sigurojnë që të dyshuarit dhe të akuzuarit të kenë të drejtën të heshtin dhe të drejtën të mos vetinkriminohen në lidhje me veprën penale për të cilën dyshohen ose akuzohen se kanë kryer. Siç është konfirmuar në Deklamimin 5 të Direktivës, gjatë marrjes në pyetje individët nuk duhet të detyrohen të ofrojnë informata, dëshmi apo dokumente inkriminuese.⁴⁸ Në thelb, kjo dispozitë mbron lirinë e të dyshuarit dhe të akuzuarve që të zgjedhin nëse dëshirojnë të flasin ose të heshtin gjatë marrjes në pyetje.

42. Siç ka deklaruar GJEDNJ-ja, e drejta për të heshtur dhe për të mos inkriminuar veten janë elemente thelbësore të së drejtës për një gjykim të drejtë. Nuk është rastësi që të gjitha të drejtat e tjera të mbrojtura sipas direktivave të Udhërrëfyesit (p.sh. e drejta për të pasur avokat, e drejta për informim, e drejta për ndihmë juridike etj.) kanë për qëllim të forcojnë mbrojtjen e të drejtave për të heshtur dhe për të mos u vet-inkriminuar. Sipas Direktivës mbi të Drejtën për Informim, të dyshuarit dhe të akuzuarit duhet që menjëherë të informohen në lidhje me të drejtën e tyre që të heshtin. Rëndësia e informimit të një të dyshuari për të drejtën e heshtjes është e tillë që, edhe kur një person me dashje pajtohet të japë deklarata në polici pasi të jetë informuar se fjalët e tij mund të përdoren si dëshmi kundër tij, kjo nuk mund të konsiderohet

⁴⁷ Po aty, paragrafët 18-20.

⁴⁸ Deklamimi 25, direktiva.

si një zgjedhje e bazuar plotësisht në informata nëse ai nuk është njoftuar shprehimisht për të drejtën e tij që të heshtë. Njëloj, një nga përfitimet e së drejtës për të pasur avokat që mbrohet në kuadër të Direktivës mbi të Drejtën për të Pasur Avokat, është se avokatët mund të ndihmojnë të dyshuarit dhe të akuzuarit që të kuptojnë dhe të ushtrojnë të drejtën e tyre për të heshtur.

43. GJEDNJ-ja ka konstatuar se, megjithëse nuk përmendet në mënyrë specifike në nenin 6 të KEDNJ-së, e drejta për të heshtur dhe e drejta për të mos inkriminuar veten janë standarde ndërkombëtare përgjithësisht të pranuar të cilat janë në zemër të nocionit të një procedure të ndershme penale sipas nenit 6 të KEDNJ-së.⁴⁹ Prandaj, kjo është një fushë ku direktiva kodifikon qasjen e GJEDNJ-së dhe thekson qartë se e drejta për të heshtur dhe për të mos inkriminuar veten janë elemente thelbësore të së drejtës për t'u konsideruar i pafajshëm derisa të vërtetohet fajësia. Në rastin *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ-ja deklaroi se arsyetimi i këtyre të drejtave "qëndron, ndër të tjera, në mbrojtjen e të akuzuarit nga detyrimet e padrejta të vendosura nga autoritetet, duke kontribuar kështu në shmangien e gabimeve gjyqësore dhe në përmbushjen e qëllimeve të nenit 6."⁵⁰

Rasti *Saunders kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 17 dhjetor 1996, Raportet e Aktgjyqimeve dhe Aktvendimeve 1996-VI

Ky rast kishte të bënte me një njeri që ishte dënuar për vepra penale që lidheshin me konspiracion, kontabilitetin e rremë dhe vjedhjen. Gjatë hetimit, policia u mbështet në një ligj vendor që përcaktonte se refuzimi për t'u përgjigjur në pyetjet e bëra nga inspektorët e emëruar nga Departamenti i Tregtisë dhe Industrisë konsiderohet vepër penale, dhe që ka paraparë se përgjigjet në pyetje të tilla duhet të jenë të pranueshme për gjykatën. Meqë duhej të zgjidhte mes inkriminimit të vetes dhe të shpallurit fajtor për shpërfillje të gjykatës, aplikanti u pajtua që t'i përgjigjej pyetjeve dhe të japë deklaratat gjatë nëntë intervistave, të cilat u paraqitën gjatë gjyqimit të tij dhe të cilat u morën parasysh në vlerësimin e fajësisë.

Aplikanti u ankua se ishte detyruar të jepte deklaratat, që shkeli të drejtën e tij për të mos inkriminuar veten, dhe se përdorimi i deklaratave gjatë gjyqimit të tij përbënte shkelje të të drejtave të tij sipas nenit 6(1) të KEDNJ-së. Shteti i paditur pretendoi, ndër të tjera, se ekzistonte një interes publik në sjelljen e ndershme të kompanive dhe në ndjekjen penale efektive të atyre që përfshiheshin në mashtrime komplekse të korporatave. Ky interes i fundit kërkonte që ata që ishin të dyshuar të detyroheshin t'u përgjigjeshin pyetjeve të inspektorëve dhe që autoritetet e ndjekjes penale të mund të mbështeten në ato përgjigje të nxjerra në çdo gjykim të mëvonshëm penal.

GJEDNJ-ja refuzoi argumentin e shtetit të paditur se kompleksiteti i rasteve të mashtrimit të madh dhe interesi publik për sigurimin e dënimit e arsyetonin detyrimin e ushtruar. GJEDNJ-ja deklaroi se "nuk mund të thirret në interesin publik për të justifikuar përdorimin e përgjigjeve të marra në mënyrë të detyrueshme në një hetim jo-gjyqësor për të inkriminuar të akuzuarit gjatë procedurave gjyqësore". Përveç kësaj, GJEDNJ-ja konstatoi se "e drejta për të mos u vetinkriminuar, në veçanti, supozon që prokuroria në një çështje penale synon ta dëshmojë rastin e saj kundër të akuzuarit pa përdorur dëshmi të marra nëpërmjet metodave të shtrëngimit ose shtypjes në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit.

⁴⁹ [Rasti *Saunders v the United Kingdom*](#), 17 dhjetor 1996, paragrafi 68, Raportet e Aktgjyqimeve dhe Aktvendimeve 1996-VI.

⁵⁰ Po aty.

Në këtë kuptim, e drejta në fjalë është e lidhur ngushtë me prezumimin e pafajësisë të përfshirë në nenin 6(2) të Konventës.⁵¹ Prandaj, GJEDNJ-ja konstatoi shkelje të nenit 6(1) dhe (2) të KEDNJ-së.

44. Në rastin *Allan kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ-ja vendosi se "përderisa e drejta për të heshtur dhe privilegji kundër inkriminimit të vetes janë menduar kryesisht për t'u mbrojtur nga detyrimet e padrejta të vendosura nga autoritetet dhe marrja e dëshmive përmes metodave të shtrëngimit ose shtypjes në kundërshtim me vullnetin e të akuzuarit, fushëveprimi i së drejtës nuk kufizohet vetëm në rastet kur kërcënimi është përdorur për ta detyruar të akuzuarin të dëshmojë ose kur vullneti i të akuzuarit ka qenë drejtpërdrejt i mbingarkuar në një farë mënyre."⁵² Në të vërtetë, liria e zgjedhjes dëmtohet kur një i dyshuar ka vendosur të heshtë dhe autoritetet përdorin taktika mashtruese me qëllim që ta shtyjnë të rrëfëhet ose të japë deklarata të tjera të një natyrës inkriminuese, deklarata të cilat nuk ishin në gjendje t'i merrnin gjatë marrjes në pyetje.⁵³

Rasti *Heaney dhe McGuinness kundër Irlandë*, nr. 34720/97, ECHR 2000-XII⁵⁴

Sipas një ligji irlandez që ishte në fuqi në atë kohë, sa herë që një person ndalohej në paraburgim, policia mund të kërkonte një raport të plotë të lëvizjeve dhe veprimeve të të paraburgosurit gjatë një periudhe të caktuar si dhe të gjitha informatat në posedonim të tij në lidhje me kryerjen e ndonjë vepre penale. Ligji parashihte gjithashtu që nëse të dyshuarit ose të akuzuarit refuzonin të bashkëpunonin, ata do të ishin fajtorë për vepër penale dhe do të dënoheshin me burg për një kohë të caktuar.

Kur aplikantët arrestoheshin, ata informoheshin për të drejtën e tyre që të heshtin dhe të mos vetinkriminohen. Megjithatë, kur zgjodhën t'i ushtronin këto të drejta, ata u informuan nga policia se, sipas ligjit në fjalë, ata do përballeshin me dënim dhe burgim prej gjashtë muajsh. Të dy parashtruesit vazhduan të heshtnin. Më pas, ata u akuzuan për veprën penale të anëtarësimit në një organizatë të paligjshme dhe mos raportimit të lëvizjeve të tyre. Parashtruesit u liruan nga akuza për anëtarësim në një organizatë të paligjshme, por secili u dënua për mos ofrimin e raportit të lëvizjeve të tyre gjatë një periudhe të caktuar sipas ligjit irlandez të lartpërmendur.

GJEDNJ-ja konstatoi se "shkalla e detyrimit" e vendosur ndaj aplikantëve përmes zbatimit të nenit përkatës të ligjit irlandez me qëllim që t'i detyronte të japin informacione në lidhje me akuzat kundër tyre sipas atij ligji në fakt shkatërroi vetë thelbin e privilegjit të tyre kundër vetinkriminimit dhe të drejtën e tyre që të heshtnin. Qeveria pretendoi se ligji ishte reagim proporcional ndaj kërcënimit terrorist dhe kërcënimit të sigurisë, duke pasur parasysh nevojën për të siguruar administrimin e duhur të drejtësisë dhe ruajtjen e rendit dhe qetësisë publike. GJEDNJ-ja konsideroi se kërkesat e përgjithshme të drejtësisë të përfshira në nenin 6 të KEDNJ-së, duke përfshirë të drejtën për të mos

⁵¹ Po aty.

⁵² Rasti *Allan v the United Kingdom*, nr. 48539/99, paragrafi 50, ECHR 2002-IX

⁵³ Po aty.

⁵⁴ Rasti *Heaney and McGuinness v Ireland*, nr. 34720/97, ECHR 2000-XII

u vetinkriminuar, "zbatohen në procedurat penale në lidhje me të gjitha llojet e veprave penale pa dallim, nga më të thjeshtat deri te ato më komplekset". GJEDNJ arriti në përfundimin se nuk duhej mbështetur në interesin publik për të justifikuar përdorimin e përgjigjeve të marra detyrimisht në një hetim jo-gjyqësor për t'i inkriminuar të akuzuarit gjatë procedurave gjyqësore.

GJEDNJ-ja konstatoi se shqetësimet në lidhje me sigurinë dhe rendin publik nuk mund të justifikojnë një dispozitë që shuan vetë thelbin e të drejtave të aplikantëve për të heshtur dhe për të mos u vetinkriminuar, të garantuara me nenin 6(1) të KEDNJ-së. Prandaj, GJEDNJ-ja konkludoi se kishte pasur shkelje të së drejtës së aplikantëve për të heshtur dhe të së drejtës së tyre për të mos u vetinkriminuar, të garantuara nga neni 6(1) i KEDNJ-së, si dhe të së drejtës për t'u konsideruar të pafajshëm sipas nenit 6(2) të KEDNJ.

ii. *Përjashtimet nga parimi i përgjithshëm*

45. Neni 7(3) i direktivës përcakton se ushtrimi i të drejtës për të mos u vetinkriminuar nuk cenon veprimet e autoriteteve kompetente që synojnë mbledhjen e dëshmive të siguruara në mënyrë të ligjshme përmes përdorimit të kompetencave ligjore të detyrimit dhe të cilat ekzistojnë pa marrë parasysh vullnetin e të dyshuarve apo të të akuzuarve. Sipas Deklamimit 29 të direktivës, kjo përfshin materialet e marra në bazë të një urdhërarresti, materialet për të cilat ekziston një detyrim ligjor i ruajtjes dhe ofrimit sipas kërkesës së mostrave të frymëmarrjes, gjakut ose urinës dhe indeve trupore me qëllim të testimit të ADN-së.⁵⁵

46. Për të përcaktuar se çfarë nënkuptohet me "kompetenca ligjore të detyrimit", është e nevojshme t'i kthehemi jurisprudencës së GJEDNJ-së. Në rastin *Jalloh v Germany*, Dhoma e Madhe vendosi se për të përcaktuar nëse është shkelur e drejta e aplikantit për të mos u vetinkriminuar, GJEDNJ-ja do t'i ketë parasysh faktorët e mëposhtëm:⁵⁶

- a) natyrën dhe shkallën e detyrimit të përdorur për të marrë dëshmi;
- b) peshën e interesit publik në hetimin dhe dënimin e veprës penale në fjalë;
- c) ekzistencën e ndonjë mase mbrojtëse përkatëse në procedurë; dhe
- d) mënyrën e përdorimit të çfarëdo material të marrë në mënyrë të tillë.

Rasti *J.B. v Switzerland*, nr. 31827/96, ECHR 2001-III

Aplikanti ishte ngarkuar me veprën që kishte të bënte me evazionin fiskal. Në më shumë se një rast, atij iu kërkua t'i paraqiste të gjitha dokumentet në lidhje me kompanitë në të cilat kishte investuar para. Ai nuk e bëri këtë në asnjë rast dhe u gjobit katër herë. Ai pretendonte se procedurat penale kundër tij ishin të padrejta dhe në kundërshtim me nenin 6(1) të KEDNJ-së duke qenë se ishte i detyruar të paraqiste dokumente që mund të inkriminonin atë.

GJEDNJ-ja konstatoi se autoritetet kishin tentuar të detyronin aplikantin të paraqiste dokumente që do të jepnin informata lidhur me të ardhurat e tij me qëllim të vlerësimit të taksave të tij. Aplikanti nuk mundi të dëshmojë se asnjë nga të ardhurat shtesë që rezultojnë nga këto dokumente nga burimet e pataksuara nuk përbënte vepër penale që kishte të bënte me evazionin fiskal.

⁵⁵ Deklamimi 29, direktiva.

⁵⁶ Rasti *Jalloh v Germany* [GC], nr. 54810/00, paragrafi 117, ECHR 2006-IX.

Prandaj, GJEDNJ-ja konstatoi se autoritetet kishin shkelur të drejtën për të mos u vetinkriminuar dhe rrjedhimisht kishte pasur shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së.

47. Sa i përket natyrës dhe shkallës së detyrimit, GJEDNJ-ja ka vendosur që përdorimi i kompetencave të detyrimit në marrjen e dëshmive justifikohet nga interesi publik në ndjekjen penale të krimit, përderisa nuk shkel të drejtat e tjera, siç është ndalimi i trajtimit çnjerëzor dhe degradues dhe i torturës sipas nenit 3 të KEDNJ-së.⁵⁷ Kjo gjithashtu është veçanërisht e rëndësishme sa i përket "mënyrës së përdorimit të materiali të marrë në mënyrë të tillë". GJEDNJ-ja ka konfirmuar se përdorimi i çfarëdo dëshmie të marrë në kundërshtim me nenin 3 të KEDNJ-së do të bëjë që procedurat gjyqësore të jenë të padrejta.

Rasti *Jalloh v Germany* [GC], nr. 54810/00, ECHR 2006-IX.

Pas arrestimit të tij nën dyshimin për përfshirje në veprën penale të shitblerjes së drogës, z. Jalloh ishte parë duke gëlltitur një qese të vogël plastike, e cila besohej se përmbante drogë. Me autorizimin e prokurorit publik, një emetik (mjet për nxitjen e të vjellave) u administrua me forcë për të provokuar vjelljen e qeses së gëlltitur. Në spital, ai u mbajt dhe u shtrëngua nga katër zyrtarë policorë. Përmes forcës, mjeku e injektoi atë me apomorfin dhe aplikoi emetikun përmes një tubi të futur në barkun e tij përmes hundës, gjë që bëri që z. Jalloh ta vjellë një qese që përmbante kokainë.

Dhoma e Madhe deklaroi se "për të përcaktuar nëse është shkelur e drejta e aplikantit për të mos u vetinkriminuar, GJEDNJ-ja do t'i ketë parasysh faktorët e mëposhtëm: natyrën dhe shkallën e detyrimit të përdorur për të marrë dëshmi; peshën e interesit publik në hetimin dhe dënimin e veprës penale në fjalë; ekzistencën e ndonjë mase mbrojtëse përkatëse në procedurë; dhe mënyrën e përdorimit të çdo materiali të marrë në mënyrë të tillë". Më pas, ajo vuri në dukje se ndonëse ishte e mundur të konsiderohej se qesja e kokainës ishte dëshmi që ekzistonte pavarësisht vullnetit të të akuzuarit, përdorimi i të cilës në përgjithësi nuk është i ndaluar në procedurat penale, mënyra në të cilën u mor kjo dëshmi kërkonte një shkallë të konsiderueshme të forcës që shkaktoi një ndërhyrje të konsiderueshme në integritetin e tij fizik dhe mendor në një mënyrë që shkeli nenin 3 të KEDNJ-së. Prandaj, duke qenë se qesja e kokainës ishte dëshmi vendimtare për dënimin e tij, kishte pasur shkelje të nenit 6(1) të KEDNJ-së.

48. Sa i përket "peshës së interesit publik në hetimin dhe dënimin e veprës penale në fjalë", GJEDNJ-ja përdor një qasje të veçantë për secilin rast individual për të përcaktuar nëse shtetet kanë arritur një ekuilibër të duhur mes të drejtave të të dyshuarve dhe nevojës për të ruajtur sigurinë e publikut dhe interesin e përgjithshëm për të ndëshkuar kryerësin. Kështu, në rastin *Jalloh*, GJEDNJ-ja konstatoi se vendimi për të aplikuar me forcë emetikun (barin që nxit të vjellat) ishte joproporcional dhe nuk mund të justifikohej kur konsiderohej se kishte "në shënjestër një tregtar rruge i cili bënte shitjen e narkotikëve në një shkallë relativisht të vogël dhe të cilit në fund iu shqiptua dënimi me kusht."⁵⁸ Sipas aktgjykimit në rastin *Saunders* "nuk mund të thirret në interesi publik për të justifikuar përdorimin e përgjigjeve të marra në mënyrë të detyrueshme në

⁵⁷ Po aty, paragrafi 117.

⁵⁸ Po aty, paragrafi 119.

një hetim jogjyqësor për të inkriminuar të akuzuarit gjatë procedurave gjyqësore."⁵⁹ Ngjashëm, sipas qasjes së GJEDNJ-së në rastin *Heaney and McGuinness v Ireland*, "shqetësimet në lidhje me sigurinë dhe rendin publik nuk mund të justifikojnë një dispozitë që shuan vetë thelbin e të drejtave të aplikantit që të hesht dhe të mos u inkriminoj veten."⁶⁰

49. Sa i përket ekzistimit të masave mbrojtëse relevante në procedurë, në rastin *Jalloh*, GJEDNJ-ja vuri në dukje se parashtruesi kishte zgjedhur të heshtë dhe nuk kishte pranuar t'i nënshtrohej ekzaminimit paraprak mjekësor. Ai mund të komunikonte vetëm në një gjuhë angleze të dobët, që nënkuptonte se i ishte nënshtruar procedurës pa një ekzaminim të plotë të aftësisë së tij fizike për t'i bërë ballë.⁶¹ Përveç kësaj, në rastin *Salduz*, GJEDNJ-ja konstatoi se "qasja e hershme në avokat është pjesë e masave mbrojtëse procedurale ndaj të cilave GJEDNJ-ja do të ketë konsideratë të veçantë gjatë ekzaminimeve mbi atë nëse një procedurë ka shuar vetë thelbin e privilegjit kundër vetinkriminimit."⁶²
50. Neni 7(4) i direktivës përcakton se shtetet anëtare mund t'ua lejojnë autoriteteve të tyre gjyqësore që gjatë shqiptimit të dënimit të marrin parasysh sjelljen bashkëpunuese të të dyshuarve dhe të të akuzuarve. Kjo dispozitë ngre shqetësime për faktin se mund të përdoret si nxitje për të dyshuarit dhe të akuzuarit që të heqin dorë nga e drejta e tyre për të heshtur dhe për të mos u vetinkriminuar në këmbim të një dënimi më të shkurtër. Për një kohë, kjo ka qenë çështje shqetësuese për "Fair Trials" meqenëse është e mundur që kjo dispozitë të përdoret për justifikimin e dënimeve më të gjata në rastet kur dikush thjesht ushtron të drejtën që të hesht. Prandaj, kjo ndoshta është një fushë ku aktgjykimet e GJEDNJ-së ose sqarimi nga GJDBE-ja mund të ofrojnë pak qartësi.
51. Neni 7(5) i direktivës ndalon nxjerrjen e konkluzioneve negative vetëm për shkak se të dyshuarit apo të akuzuarit ushtrojnë të drejtën për të heshtur dhe për të mos u vetinkriminuar. Prandaj, fakti se i dyshuari ose i akuzuari ka pohuar të drejtën e tij për të heshtur ose të drejtën për të mos u vetinkriminuar nuk duhet të përdoret kundër tij dhe nuk duhet të konsiderohet në vetvete si dëshmi se personi në fjalë ka kryer veprën penale në fjalë.⁶³ Pavarësisht kësaj, Deklamimi 28 i direktivës përcakton se "kjo duhet të jetë pa cenuar rregullat kombëtare në lidhje me vlerësimin e dëshmive nga gjykatat ose gjyqtarët, me kusht që të respektohen të drejtat e mbrojtjes"⁶⁴. Kjo nënkupton se ndalimi i përcaktuar në nenin 7(5) të direktivës nuk përjashton mundësinë që gjyqtarët të marrin parasysh heshtjen e të akuzuarit për vlerësimin e dëshmive të tjera ose për qëllimin e dënimit, me kusht që, kur veprohet kështu, procedurat gjyqësore të mbesin të drejta për të paditurin.
52. Sipas praktikës gjyqësore të GJEDNJ-së, nxjerrja e konkluzioneve negative nga heshtja e të akuzuarit është në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së, përderisa masat mbrojtëse gjyqësore veprojnë për të siguruar drejtësi. Sipas pikëpamjes së GJEDNJ-së, imunitetet që ofrohen sipas të

⁵⁹ Rasti *Sounders*, paragrafi 74.

⁶⁰ Rasti *Heaney and McGuinness*, paragrafi 58.

⁶¹ Rasti *Jalloh*, paragrafi 120.

⁶² Rasti *Salduz*, supra n 29, paragrafi 54, ECHR 2008.

⁶³ Deklamimi 28.

⁶⁴ Po aty.

drejtës për të heshtur dhe për të mos u vetinkriminuar nuk mund dhe nuk duhet të pengojnë që heshtja e të akuzuarit, në situata të cilat qartazi kërkojnë një sqarim nga ai, të merret parasysh gjatë vlerësimit të besueshmërisë së dëshmive të paraqitura nga prokuroria. Praktika gjyqësore e GJEDNJ-së ka konfirmuar se kur dëshmitë e paraqitura nga prokuroria vërtetojnë *prima facie* se i akuzuari ka kryer një veprë penale, atëherë gjykatës i lejohet të nxjerrë konkluzion e fajësisë nga dështimi i të akuzuarit që të ofroj shpjegimin vetëm atëherë kur ky është i vetmi supozim i bazuar në arsye të shëndoshë. Për shembull, në rastin *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ-ja konstatoi se veprimi i gjyqtarit që nxori konkludimin e fajësisë nga fakti se aplikanti kishte heshtur gjatë hetimit nga policia dhe gjatë gjykimit ishte në përputhje me nenin 6(1) të KEDNJ-së.⁶⁵ Në këtë rast, dëshmitë kundër aplikantit ishin shumë të forta.

Rasti *John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 8 shkurt 1996, Raportet e Aktgjykimeve dhe Aktvendimeve 1996-I

Aplikanti ishte arrestuar nën dyshimin për vepra penale në lidhje me terrorizmin. Ai zgjodhi të heshte gjatë marrjes në pyetje pavarësisht se ishte paralajmëruar që nëse do vepronte kështu, sipas një ligji kombëtar, gjykata, gjyqtari ose juria mund të nxirrin konkluzione negative. Më pas, gjatë konstatimit se aplikanti ishte fajtor, gjyqtari i procedurës nxori konkluzione negative kundër parashtruesit për faktin që ai vendosi të heshte.

GJEDNJ-ja konstatoi se roli i saj ishte të vlerësonte nëse ushtrimi i të drejtës që të heshtur nga ana e të akuzuarit, në asnjë rrethanë, nuk mund të përdoret kundër tij gjatë gjykimit apo përndryshe nëse informimi i tij paraprakisht se në kushte të caktuara heshtja e tij mund të përdoret kundër tij, duhet të konsiderohet gjithmonë si "detyrim i padrejtë". GJEDNJ-ja konstatoi se në një rrethanë, të bazuarit e dënimit vetëm në heshtjen e të akuzuarit ose në refuzimin e tij që tu përgjigjet pyetjeve ose të jap dëshmi vetë është në kundërshtim me nenin 6 të KEDNJ-së. Nga ana tjetër, GJEDNJ-ja gjithashtu konstatoi se këto imunitete nuk mund dhe nuk duhet të pengojnë që heshtja e të akuzuarit të merret parasysh gjatë vlerësimit të besueshmërisë së dëshmive të paraqitura nga prokuroria.⁶⁶

GJEDNJ-ja vuri në dukje se nxjerrja e konkluzioneve sipas ligjit kombëtar i nënshtrohet një serie të rëndësishme të masave mbrojtëse të krijuara për t'i respektuar të drejtat e mbrojtjes dhe për të kufizuar masën në të cilën mund të mbështetet në konkluzione.

Pastaj, GJEDNJ vuri në dukje se praktika gjyqësore kombëtare konfirmoi se prokurori duhet fillimisht të krijojë një rast prima facie kundër të akuzuarit. Në këtë rast, GJEDNJ-ja gjeti se dëshmitë e paraqitura kundër parashtruesit nga prokuroria ishin konsideruar nga Gjykata e Apelit se përbënin një rast "të madh" kundër tij. Sipas pikëpamjes së GJEDNJ-së, duke pasur parasysh peshën e dëshmive kundër parashtruesit, nxjerrja e konkluzioneve nga refuzimi i tij që të ofrojë shpjegime në momentin e arrestimit, gjatë marrjes në pyetje nga policia dhe gjatë gjykimit mbi arsyen e pranisë së tij në shtëpi ishte çështje e bazuar në arsye të shëndoshë dhe nuk mund të konsiderohet si e padrejtë apo e paarsyeshme në ato rrethana. Prandaj, GJEDNJ-ja konstatoi se nuk kishte shkelje të nenit 6(2) të KEDNJ-së.

⁶⁵ Rasti *John Murray v the United Kingdom*, 8 shkurt 1996, Raportet e Aktgjykimeve dhe Aktvendimeve 1996-I.

⁶⁶ Po aty, paragrafi 47.

iii. Mjetet juridike

53. Neni 10(2) i direktivës kërkon nga shtetet anëtare që të "garantojnë respektimin e të drejtave të mbrojtjes dhe të drejtësisë së procedurave gjyqësore gjatë vlerësimit të deklaratave të bëra nga të dyshuarit ose të akuzuarit apo gjatë vlerësimit të dëshmive të marra duke shkelur të drejtën për të heshtur ose të drejtën për të mos u vetinkriminuar." Ngjashëm si secila nga direktivat e Udhërrëfyesit të mëparshëm, direktiva nuk shpjegon se si shtetet anëtare duhet të sigurojnë që të drejtat e mbrojtjes dhe drejtësisë të procedurave gjyqësore të mbrohen nëpërmjet një mjeti të përshtatshëm juridik, duke e lënë në diskrecionin e shteteve anëtare që të vendosin se cili duhet të jetë ky mjeti i përshtatshëm juridik.

Pyetjet para-transpozimit

A janë e drejtat për të heshtur dhe për të mos u vetinkriminuar të mbrojtura në juridiksionin tuaj? Cilat mjete juridike, nëse ka ndonjë, ekzistojnë në ligj për shkelje të së drejtës për të heshtur dhe/ose të së drejtës për të mos u vetinkriminuar?

A konsideroni se ka probleme të veçanta në lidhje me mbrojtjen e të drejtës për të heshtur dhe/ose të drejtës për të mos u vetinkriminuar në juridiksionin tuaj? Cilët janë shtytësit kryesorë të këtyre problemeve?

A është e nevojshme reforma legislative në juridiksionin tuaj për të siguruar që direktiva të transpozohet në mënyrë adekuate në lidhje me të drejtat për të heshtur dhe për të mos u vetinkriminuar? A ka ndonjë zgjidhje tjetër jo-legislative për problemet që shihni në praktikë në lidhje me këto të drejta?

A ka ndonjë pyetje në lidhje me të drejtën për të heshtur dhe/ose të drejtën për të mos u vetinkriminuar, për të cilën mendoni se është e dobishme të kërkohet nga GJDBE-ja të ofrojë sqarime në lidhje me të?

VI. PËRDORIMI I DIREKTIVËS PARA AFATIT TË FUNDIT PËR TRANSPOZIMIN E SAJ

54. Direktiva hyri në fuqi më 29 mars 2016 (njëzet ditë pas datës së botimit në Gazetën Zyrtare të BE-së). Sidoqoftë, në kohën e publikimit të këtij manuali, afati i fundit për transpozim në ligjin kombëtar (1 prill 2018) është ende larg. Si e tillë, direktiva ende nuk është e detyrueshme për shtetet anëtare dhe e zbatueshme përmes parimit të ndikimit të drejtpërdrejt të drejtës së BE-së në gjykatat kombëtare.

55. Sidoqoftë, në këtë pjesë shpjegojmë se si direktiva megjithatë mund të ketë efekt ligjor në kontekstin kombëtar gjatë periudhës para transpozimit. Më poshtë do shqyrtojmë disa praktika gjyqësore përkatëse para se të parashtrojmë shembuj nga tri shtete anëtare në të cilat direktivat e Udhërrëfyesit janë përdorur në proceset gjyqësore, ashtu siç edhe ju ndoshta dëshironi të veproni me direktivën në fjalë.

A. Jurisprudenca e GJDBE-së

56. GJDBE-ja ka konfirmuar se ndonëse direktivat nuk kanë efekt të drejtpërdrejtë para afatit të fundit për transpozim, ato nuk janë tërësisht pa efekt para kësaj kohe. Në rastin *Kolpinguis*,⁶⁷ GJDBE-ja konfirmoi se detyra e përputhjes së interpretimit mund të fillonte pas miratimit të një direktive dhe nuk ishte domosdoshmërisht e varur nga skadimi i afatit të fundit për transpozim. Në rastin *Wallonie*,⁶⁸ GJDBE-ja ishte pyetur nëse shteteve anëtare u ndalohej të miratonin masa që janë në kundërshtim me një direktivë gjatë periudhës së parashikuar për transpozimin e saj. GJDBE-ja kishte thënë:

- Gjatë periudhës së transpozimit, shtetet anëtare duhet t'i ndërmarrin masat e nevojshme për të siguruar që rezultati i paraparë nga direktiva të arrihet në fund të asaj periudhe.
- Gjatë kësaj periudhe, ato duhet të përmbahen nga ndërmarrja e masave të cilat mund ta rrezikojnë seriozisht rezultatin e paraparë.

57. Këto baza të njëjta më pas u zbatuan në rastet e mëvonshme duke zhvilluar parimin *Wallonie*, përfshirë këtu edhe rastin e *Adelener*,⁶⁹ që ngriti çështjen e rolit të gjykatave në interpretimin e legjislacionit para afatit të fundit për zbatim. GJDBE-ja kishte thënë:

- Duke pasur parasysh se të gjitha autoritetet e shteteve anëtare i nënshtrohen detyrimit për të siguruar që dispozitat e ligjit të Komunitetit kenë efekt të plotë, detyrimi për t'u përmbajtur nga ndërmarrja e masave që potencialisht mund ta rrezikojnë objektivin e direktivës zbatohet edhe ndaj gjykatave kombëtare.
- Që nga data në të cilën një direktivë hyn në fuqi, gjykatat e shteteve anëtare duhet të përmbahen sa më shumë që të jetë e mundur nga interpretimi i ligjit vendor në at mënyrë që pas skadimit të periudhës së transpozimit mund të vë në rrezik serioz arritjen e objektivit të ndjekur nga ajo direktivë”.

58. Në rastin *Mangold*,⁷⁰ GJDBE-ja dha një vendim i cili konsiderohet kontrovers. GJDBE-ja konstatoi se kur një direktivë ofron një artikullim më të hollësishëm të një parimi i cili tashmë është i vendosur në të drejtën e BE-së (në rastin e *Mangold*, ky ishte parimi i mos-diskriminimit në bazë të moshës), atëherë parimi i të drejtës së BE-së duhet të mbetet në fuqi pavarësisht nëse ka skaduar afati për transpozimin e direktivës në fjalë. Duke pasur parasysh se direktiva ofron udhëzime të hollësishme për shtetet anëtare në lidhje me zbatimin e një të drejte themelore veçse të mbrojtur në nenin 48 të Kartës së BE-së për Liritë Themelore, atëherë një qasje e ngjashme mund të aplikohet.

⁶⁷ Rasti 80/86 *Kolpinguis Nijmegen*, [ECLI:EU:C:1987:431](#).

⁶⁸ Rasti C-129/96 *Inter-Environnement Wallonie ASBL v Région wallonne* ([ECLI:EU:C:1997:216](#)).

⁶⁹ Rasti C-212/04 *Adeneler* [ECLI:EU:C:2006:443](#).

⁷⁰ Rasti C-144/04 *Werner Mangold v Rüdiger Helm* [ECLI:EU:C:2005:709](#).

B. Disa ide për periudhën para afatit të fundit për transpozim

59. Mendojmë se do të jetë vërtetë sfiduese që të arrihen rezultate pozitive në bazë të direktivës para afatit të fundit për transpozim (e njëjta gjë vlen edhe për direktivat e tjera që në kohën e duhur mund të miratohen krahas Udhërrëfyesit). Më poshtë propozojmë disa argumente, edhe pse themi qartë se disa prej tyre janë vështirë të arritshme.

Argumentet e bazuara në doktrinën e rastit Wallonie

- ➔ Autoritetet kombëtare, si ato hetuese ashtu edhe gjykatat, janë të obliguara nga detyrimi tani i artikulluar në nenin 4(3) të TBE-së që të “ndërmarrin çfarëdo mase të përshtatshme, qoftë të përgjithshme apo të veçantë, për të siguruar përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga Traktatet”, që përfshin direktivën. Detyrimet sipas nenit 288 për t'i arritur objektivat e kësaj direktive tashmë janë krijuar në bazë të hyrjes në fuqi të asaj mase.
- ➔ Ndoshta, duke u mbështetur në rastin *Kolpinguis*, detyra e gjykatave kombëtare që të interpretojnë legjislacionin kombëtar në përputhje me një direktivë lind para skadimit të afatit të fundit për transpozimin e direktivës, prandaj, nëse ligji kombëtar mund të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me direktivën, atëherë ashtu edhe duhet të interpretohet.
- ➔ Në mënyrë më të qartë është përcaktuar detyrimi i shtetit anëtar që të përmbahet nga ndërmarrja e masave, para skadimit të afatit të fundit për transpozimin e një direktive, e që mund të rrezikojnë seriozisht arritjen e objektivave të kësaj të fundit pas këtij afati të fundit (*rasti Wallonie*). Kjo përfshin gjykatat, të cilat janë të detyruara të përmbahen nga miratimi i interpretimeve të ligjit kombëtar në këtë periudhë që do të thotë se rezultatet nuk do të arriheshin pas skadimit të afatit të fundit për transpozim.
- ➔ Përderisa praktika gjyqësore në rastin *Wallonie* i referohet qartë masave legislative, ndoshta edhe masat e një natyre më të veçantë (siç janë veprimet hetimore) duhet të shmangen në periudhën para skadimit të afatit të fundit për transpozimin e direktivës nëse kanë mundësi të rrezikojnë seriozisht objektivat e kësaj të fundit. Pra, në veçanti, nëse një person do të merret në pyetje, atëherë marrja në pyetje në një mënyrë që është në kundërshtim me direktivën (p.sh. duke përdorur fuqitë e paligjshme të detyrimit për të nxjerrë rrëfime kundër të drejtës për të mos u vetinkriminuar) do të konsiderohej si ndërmarrje e një veprimi pozitiv që si i tillë rrezikon drejtësinë në procedurë gjyqësore, e që është në kundërshtim me objektivin e Direktivës për Presumimin e Pafajësisë.

Argumentet e bazuara në doktrinën e rastit Mangold

- ➔ E drejta për t'u konsideruar i pafajshëm derisa të dëshmohet fajësia është një aspekt i së drejtës për gjykim të drejtë që njihet nga të gjitha kushtetutat e shteteve anëtare, dhe mund të konsiderohet si parim i përgjithshëm i së drejtës së BE-së. Kjo është konfirmuar nga Karta, ku nenet 47 dhe 48 mbrojnë të drejtën për gjykim të drejtë dhe të drejtat e mbrojtjes. Fakti që direktiva jep një grup të caktuar të të drejtave për zbatimin e kësaj të fundit nuk zhvlerësohet nga ekzistenca e normës së vetë ligjit primar.

- E drejta e paraparë në Kartë/parimi i përgjithshëm veçse janë në kuadër të fushëveprimit të së drejtës së BE-së në bazë të direktivës, dhe megjithëse ende nuk janë marrë masa specifike për zbatimin e kësaj të fundit, Karta/parimi i përgjithshëm megjithatë mund të konsiderohen si bazë për t'u mbështetur nga ana e individit, dhe legjislacioni kombëtar kundërthënës mund të lihet mënjanë (në fakt, nëse është kundërthënës, edhe ashtu do të duhet të ndryshohet në procesin e zbatimit).

Referimi në GJDBE?

- Kërkoni referencën në GJDBE duke shikuar efektet e praktikës gjyqësore të rastit *Wallonie dhe Mangold* në kontekstin e rasteve penale, në veçanti në lidhje me masën në të cilën një “rezultat” në kundërshtim me direktivën duhet të kuptohet si përfshirje e dënimit dhe e zbatimit të ndëshkimeve bazuar në veprime që janë në kundërshtim me direktivën, edhe pse këto merren në bazë të masave të zbatueshme para miratimit të legjislacionit që zbaton këtë të fundit.

Argumentet e bazuara në efektet e GJEDNJ-së

- Varësisht nga statusi i KEDNJ-së në juridiksionin tuaj, mund të argumentoni se ligjet kombëtare janë në kundërshtim me KEDNJ-në. Direktiva thjesht sqaron, kodifikon dhe i nënshtrohet detyrimeve për mekanizmat e zbatimit të ligjit të BE-së që edhe ashtu ekzistojnë në KEDNJ, dhe rrjedhimisht këto detyrime mund të konsiderohen si norma të KEDNJ-së në mënyrën e parashikuar nga rregullimet kushtetuese kombëtare. Për shembull, nëse ligji kombëtar në përgjithësi lejon zbatimin e prezumimeve të pakundërshtueshme të fakteve apo ligjit në lidhje me disa vepra penale të caktuara, mund të thoni se - siç sqarohet nga direktiva - standardet e KEDNJ-së përcaktojnë qartë se këto prezumime duhet të jenë të kundërshtueshme; ato duhet të zbatohen në mënyrë të veçantë për secilin rast individual; dhe autoritetet gjithmonë duhet të synojnë një balancim midis rëndësisë së asaj që është në rrezik dhe të drejtave të mbrojtjes, prandaj gjykatat duhet t'i ndërlidhin pasojat me mospërputhjen me KEDNJ-në në pajtim me rregullimet kushtetuese të zbatueshme.

VII. PËRFUNDIM

60. Ky manual është menduar të shërbejë si udhëzues për praktikantët, organizatat e shoqërisë civile dhe çdo akter tjetër që përfshihet dhe merr pjesë në procesin e transpozimit të direktivës përmes reformës legjislative dhe proceseve gjyqësore vendore. Ky ofron një pasqyrë të dispozitave përkatëse të direktivës dhe një shqyrtim të praktikës gjyqësore përkatëse të GJEDNJ-së që duhet të përdoret për të interpretuar direktivën gjatë fazës para transpozimit. Qëllimi është të ofrojë udhëzime se si mund të përdoret direktiva gjatë periudhës para transpozimit. Inkurajon anëtarët e LEAP-it dhe rrjetet e tyre që t'i identifikojnë problemet me të drejtën dhe praktikën kombëtare, probleme të cilat mund t'i trajtojë direktiva, me qëllim që të sigurohet një kornizë për zhvillimin e strategjive për ofrimin e informatave në lidhje me reformën në të drejtën dhe praktikën në mënyrë që direktiva të transpozohet dhe të zbatohet në mënyrë efektive.

61. Ky manual do t'u shpërndahet mijëra avokatëve anëmbanë Evropës, të cilët i ftojme:

- [Të na kontaktojnë](#), dhe të na tregojnë se si po shkon puna në lidhje me transpozimin e direktivës në juridiksionin tuaj përkatës.

- Të na tregoni nëse gjykatat nxjerrin vendime pozitive në kuptim të direktivës. Këto mund të jenë të dobishme për njerëzit në vendet tjera.
- Nëse lindin pyetje në lidhje me interpretimin, të kini parasysh shtegun e GJDBE-së: shikoni Manualin për përdorimin e të drejtës së BE-së, dokumentin tonë të vitit 2014 në lidhje me qasjet strategjike të GJDBE-së⁷¹ dhe videon tonë online të trajnimit në lidhje me procedurën e vendimeve paraprake në praktikën penale.⁷²
- Të vizitoni rregullisht faqen tonë të internetit www.fairtrials.org për të rejtat më të fundit sa i përket zhvillimeve kryesore që kanë të bëjnë me direktivat, dhe lajmet për trajnimet individuale.
- Të vini tek ne nëse nuk mund të pajtoheni asesi me gjykatat, sepse ne mund të eksplorojmë mundësi të tjera siç është dërgimi i ankesave në Komisionin Evropian.
- Të përfshihen në shtyrjen e çështjeve përpara në kontekstin vendor: shih dokumentin tonë të titulluar "Towards an EU Defence Rights Movement"⁷³ për ide konkrete në lidhje me artikujt, procedurat gjyqësore, konferencat etj.

LEAP
Fair Trials
Pranverë 2017

⁷¹ Fair Trials, *Strategic approaches to litigation before the CJEU on the Roadmap Directives and EAW*, 2014, i qasshëm në <http://www.fairtrials.org/wp-content/uploads/140818-CJEU-meeting-report.pdf>.

⁷² E qasshme në <http://www.fairtrials.org/fair-trials-defenders/legal-training/online-training/>.

⁷³ Towards an EU Defence Rights Movement, supra nr. 10.